



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 3834/Prot.
14

Tiranë, më 21.7.2025

URDHËR

Nr. 344, datë 21.7.2025

PËR

MIRATIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR TË LËNDËS SË TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT (TIK) PËR KLASËN E KATËRT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 45 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të shkronjës "dh", dhe "e" të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)" dhe të urdhrit nr.609, datë 20.12.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani",

URDHËROJ:

1. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për klasën e katërt" sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



PROGRAMI I LËNDËS “TIK” ARSIMI FILLOR KLASA 4

FUSHA “TEKNOLOGJI DHE TIK”

PROGRAM I RI



PËRMBAJTJA

I. HYRJE.....	4
II. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS	5
2.1 Objektivat e përgjithshme të lëndës së TIK-ut në arsimin fillor	5
III. STRUKTURA E PROGRAMIT TË TIK-ut	7
IV. KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA	11
4.1 Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit	11
4.2 Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e TIK-ut.....	17
4.3 Kompetencat e lëndës së TIK-ut dhe rezultatet e të nxënit	19
V. PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	24
5.1 Koha mësimore e sugjeruar për secilën tematikë	24
5.2 Përmbajtja e programit mësimor për klasën e katërt	25
Tematika: Teknologjia dhe bota e kompjuterit.....	26
Tematika: Përmbajtja digjitale	29
Tematika: Përpunimi i të dhënave	32
Tematika: Të menduarit kompjuterik dhe kodimi	33
Tematika: Siguria e të punuarit në kompjuter	36
5.3 Shembuj veprimtarish për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve).	37

VI. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES.....	39
6.1 Roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale në mësimin e TIK-ut	42
6.2 Roli i projekteve kurrikulare në lëndën e TIK-ut	43
6.3 Puna me nxënësit me aftësi të kufizuara në lëndën e TIK-ut	44
6.4 Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e TIK-ut.....	44
VII. VLERËSIMI I NXËNËSVE.....	46
7.1 Parime të rëndësishme të vlerësimit të nxënësve në lëndën e TIK-ut	46
7.2 Llojet e vlerësimit në lëndën e TIK-ut	47
7.3 Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit	49
VIII. BURIMET DHE MATERIALET MËSIMORE	50
8.1 Përdorimi i TIK-ut si mjet dhe teknikë mësimore për zbatimin e qasjes STEM	52
IX. REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT	53
X. BIBLIOGRAFIA	56

I. HYRJE

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) përbën një komponent thelbësor të kurrikulës shkollore, ku nxënësit zhvillojnë aftësi digjitale për përdorimin efektiv dhe të përshtatshëm të teknologjisë, me qëllim krijimin dhe komunikimin e informacionit dhe ideve, zgjidhjen e problemeve dhe ndërveprimin në mjedise të ndryshme.

Ndryshimet digjitale dhe përhapja e teknologjive të reja, përfshirë inteligjencën artificiale, po ndikojnë në të gjitha aspektet e shoqërisë, ekonomisë dhe mjedisit, duke e përshpejtuar ritmin e ndryshimeve. Nxënësit tashmë po përjetojnë një integrim të thellë të teknologjisë në jetën e përditshme, prandaj arsimi duhet t'u përgjigjet me produkte cilësore për të transmetuar njohuri e aftësi sistematike, koherente dhe të qëndrueshme tek ta, duke garantuar krijimin e një të ardhmeje më të sigurt dhe produktive për të gjithë. Është thelbësore që nxënësit të jenë përdorues efektivë të Teknologjisë dhe TIK-ut dhe jo përdorues pasivë, duke siguruar njohuri, aftësi dhe qëndrime, të cilat rrisin besimin e nxënësve përgjatë ndërveprimit në një shoqëri gjithnjë e më digjitale .

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit ka ripërcaktuar dinamikën e komunikimit dhe bashkëpunimit, duke krijuar një komunitet global ku nxënësit ndërveprojnë me bashkëmoshatarë, mësues dhe ekspertë edukimi nga vende të ndryshme. Kjo jo vetëm që rrit aftësitë e tyre ndërpersonale, por gjithashtu i ekspozon ndaj kulturave dhe perspektivave të ndryshme. TIK-u është shndërruar në një formë të veçantë të veprimtarisë krijuese, ku nxënësit ndërveprojnë në mjedise të ndryshme duke përdorur materialet, inputet dhe proceset e duhura në përgjigje të nevojave, dëshirave dhe mundësive të tyre. Është e rëndësishme që nxënësit të vlerësojnë dhe të kuptojnë marrëdhënien komplekse ndërmjet teknologjisë dhe shoqërisë. Si qytetarë, ata duhet të jenë të aftë të bëjnë gjykime vetjake mbi çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetët e tyre, në shoqëri dhe në mjedis. Nxënësit duhet të aplikojnë njohuritë për zgjidhjen e problemeve dhe aftësitë praktike në prodhimin e produkteve dhe të sistemeve të dobishme të pranishme në shumë fusha.

Bazuar në një shoqëri të orientuar nga teknologjia dhe ndryshimet digjitale, lind natyrshëm nevoja për individë, të cilët zotërojnë që në moshë të hershme, aftësi dhe njohuri shumë të mira në fushën e TIK-ut dhe teknologjisë.

II. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS

Qëllimi i lëndës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në arsimin fillor është të zhvillojë tek nxënësit kompetencën digjitale, duke i aftësuar ata të përdorin teknologjinë në mënyrë të sigurt, krijuese dhe etike. Lënda synon të nxisë një kuptim bazë të mjedisit kompjuterik dhe përdorimit të teknologjisë në jetën e përditshme, të forcojë të menduarit logjik e kreativ përmes ushtrimeve praktike, si dhe të ndërtojë aftësi fillestare për krijimin dhe komunikimin e informacionit në formë digjitale. Lënda e TIK-ut gjithashtu synon të promovojë zhvillimin e të menduarit kompjuterik dhe të njohurive themelore të kodimit, duke i pajisur nxënësit me aftësi analitike dhe të zgjidhjes së problemeve të thjeshta në mënyrë praktike dhe të strukturuar. Qëllimi i lëndës në klasën e katërt është që t'u ofrojë nxënësve njohuri dhe aftësi themelore në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë të menduarit kompjuterik, programimin e thjeshtë, krijimin e përmbajtjeve digjitale, përpunimin bazë të të dhënave dhe mbrojtjen e sigurisë personale në mjedisin online. Lënda synon të nxisë kureshtjen, krijimtarinë dhe të menduarit kritik te nxënësit, si dhe të zhvillojë qëndrime të përgjegjshme ndaj përdorimit të teknologjisë në jetën e përditshme.

2.1 Objektivat e përgjithshme të lëndës së TIK-ut në arsimin fillor

- Të mundësojë zhvillimin e aftësive themelore në përdorimin e kompjuterit dhe pajisjeve digjitale, duke përfshirë sistemet operative dhe aplikacionet bazë, për të përgatitur nxënësit për përdorimin efektiv të teknologjisë në kontekste të ndryshme.
- Të inkurajojë zhvillimin e mendimit kritik dhe aftësive për zgjidhjen e problemeve, duke përdorur teknologjinë dhe të menduarin kompjuterik për të analizuar dhe adresuar probleme të jetës së përditshme në mënyrë inovative.
- Të promovojë krijimtarinë dhe inovacionin përmes përdorimit të teknologjisë, duke nxitur nxënësit të krijojnë përmbajtje digjitale, përfshirë grafikë, video, animacione dhe projekte të tjera kreative.
- Të përmirësojë aftësitë e komunikimit dhe bashkëpunimit në mjedisin digjital, duke përdorur platforma dhe mjete digjitale për komunikim të sigurt dhe interaktivitet cilësor në mjediset virtuale.
- Të rrisë ndërgjegjësimin për përdorimin e përgjegjshëm dhe etik të teknologjisë, duke edukuar nxënësit për rëndësinë e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

- Të edukojë nxënësit për praktikat e qëndrueshme në përdorimin e teknologjisë, duke i ndërgjegjësuar për ndikimin mjedisor të pajisjeve digjitale dhe duke promovuar mënyra për të reduktuar ndikimin negativ në mjedis.
- Të rrisë ndërgjegjësimin për sigurinë digjitale duke edukuar nxënësit për rreziqet e mundshme online dhe për masat që duhet të ndërmarrin për të siguruar mbrojtjen e pajisjeve dhe sistemeve kompjuterike.
- Të kontribuojë në një edukim të balancuar, duke iu dhënë nxënësve një përvojë të gjerë dhe sfiduese, që do t'u krijojë mundësi atyre të fitojnë një grup njohurish, kuptimesh, aftësish njohëse e përpunuese dhe kompetenca të thjeshta, duke i përgatitur në këtë mënyrë që të jenë pjesëmarrës në një botë teknologjike.

Në programin për klasën e katërt, një peshë të rëndësishme zë integrimi i aftësive të kodimit dhe të menduarit kompjuterik, duke përfshirë:

- identifikimin e detajeve të tepërta në një problem ose në një detyrë, anashkalimin e detajeve specifike të një problemi të caktuar duke lejuar krijimin e një zgjidhjeje më të përgjithshme (*abstraksioni*);
- zbërthimin e një problemi ose detyre në pjesë më të vogla, për t'i bërë problemet e ndërlikuara më të thjeshta për t'u kuptuar dhe më të menaxhueshme për t'u dhënë një zgjidhje (*dekompozimi*);
- identifikimin e hapave të nevojshëm për të zgjidhur një problem ose për të përfunduar një detyrë (*të menduarit algoritmik*);
- analizimin dhe parashikimin e outputit/rezultatit (*të menduarit logjik*);
- korrigjimin e kodit përmes testimit për identifikimin e gabimeve dhe modifikimin e tyre (*debugging*).

III. STRUKTURA E PROGRAMIT TË TIK-ut

Programi i lëndës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) synon të krijojë kushte të favorshme për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe. Në thelb, ky program synon formimin e nxënësve si individë të aftë për të kuptuar, përdorur dhe zbatuar teknologjinë në mënyrë funksionale, të sigurt dhe krijuese në jetën e tyre të përditshme. Programi i lëndës së TIK-ut në arsimin fillor (klasa e katërt) përmban rubrikat e mëposhtme:

- *Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit:* Në program është përshkruar rëndësia e kompetencave kyçe, si dhe janë pasqyruar rezultatet e të nxënit që zhvillohen nëpërmjet lëndës së TIK-ut. Lënda e TIK-ut kontribuon drejtpërdrejt në ndërtimin e kompetencave kyçe si dhe aftësive të shekullit XXI si: aftësitë digjitale, mendimi kritik dhe zgjidhja problemore, aftësitë e buta, aftësitë sociale, etj. Gjatë zhvillimit të kompetencave lëndore, krijohen mundësi për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave kyçe.
- *Temat ndërkurrikulare:* Kjo rubrikë përshkruan konceptin e temave ndërkurrikulare dhe jep shembuj se si lënda e TIK-ut mund të kontribuojë në integrimin e tyre, si: identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; qytetaria aktive dhe sipërmarrja; shëndeti mendor e fizik; siguria; zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore; teknologjia, shoqëria dhe media.
- *Kompetencat e lëndës dhe rezultatet e të nxënit:* Janë përshkruar kompetencat lëndore dhe rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë. Lënda synon të pajisë nxënësit me kompetenca për të kuptuar mjedisin kompjuterik, për të ndërvepruar në mënyrë të sigurt online, për të krijuar përmbajtje digjitale të thjeshta, për të analizuar dhe përfaqësuar të dhëna në mënyrë vizuale dhe për të zhvilluar të menduarin kompjuterik dhe aftësitë bazë të kodimit.
- *Përmbajtja mësimore dhe rezultatet e të nxënit:* Përshkruhet koha mësimore e sugjeruar sipas klasës dhe nivelit të vështirësisë së tematikave, duke përfshirë hapësira për punë individuale, bashkëpunim dhe projekte. Detajohen tematikat, përmbledhja e përmbajtjes, njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet për secilën prej tyre.
- *Metodologjia e mësimdhënies:* Paraqiten parimet që duhet të udhëheqin mësuesit në zbatimin e programit, metodat dhe teknikat që mund të përdoren për të zhvilluar kompetencat kyçe dhe lëndore, puna me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe me nxënësit e talentuar, rëndësia e përdorimit të platformave interaktive etj.

- *Vlerësimi i nxënësve:* Përshkruan në mënyrë të përmblëdhur llojet e vlerësimit të nxënësit, shembuj të instrumenteve të vlerësimit etj. Gjithashtu janë paraqitur edhe shembuj të niveleve të arritjes së rezultateve të të nxënësve. Vlerësimi synon të jetë gjithëpërfshirës, zhvillues dhe i orientuar drejt përmirësimit të nxënësit.
- *Burimet dhe materialet didaktike:* Identifikohen burimet që mund të përdoren gjatë mësimdhënies, me fokus në përdorimin e mjeteve digjitale si mbështetje për zhvillimin e kompetencave.
- *Rekomandime për zbatimin e programit:* Jepen udhëzime për përdorues të ndryshëm të programit lëndor siç janë: mësuesit, autorët e teksteve mësimore, hartuesit e testeve kombëtare, vlerësuesit e jashtëm të cilësisë, prindërit dhe nxënësit.
- *Ndryshimet përmbajtësore. Përshkruhen përditësimet kryesore të përfshira në programin e rishikuar të lëndës, në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe arsimore.*

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga dokumentet bazë të politikave arsimore: Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, Kurrikula Bërthamë dhe Plani Mësimor i Arsimit Bazë. Si i tillë, ky dokument i shërben:

- **Nxënësit** për zhvillimin e kompetencave kyçe dhe kompetencave të lëndës së TIK-ut në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri;
- **Mësuesit** për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe të arritjeve të nxënësve në klasë dhe jashtë saj;
- **Prindërve** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kritereve të vlerësimit në periudha të caktuara kohore;
- **Hartuesve** të teksteve shkollore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe për nxënësit.

Programi i TIK-ut ka në thelb të tij krijimin e kushteve për ndërtimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe që lidhen me të. Në program përshkruhet lidhja e TIK-ut me fushat e tjera të të nxënësve, në mënyrë që kurrikula e arsimit bazë të shihet si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor të formimit të nxënësve. Programi përmban pesë tematika, të cilat krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe të zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe. Në program paraqitet edhe koha mësimore për secilën tematikë, e cila ndryshon nga klasa në klasë. Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënie është kusht për zbatimin e programit,

për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Në këtë program, vlerësimi i procesit të të nxënit është komponent thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe të procesit të të nxënit, si dhe përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënie është kusht për zbatimin e programit. Për të zhvilluar kuptimin e koncepteve themelore, programi rekomandon një ndërthurje të aktiviteteve të bazuara në kompjuter, aktiviteteve “unplugged” (pa pajisje digjitale), dhe aktiviteteve që nxisin rishikimin dhe reflektimin mbi përvojën e të nxënit.

Struktura e programit të lëndës TIK





Diagrama 1: Korniza konceptuale e programit



IV. KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA

4.1 Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit

Kompetencat kyçe janë një kombinim i njohurive, aftësive, vlerave dhe qëndrimeve, të cilat mundësojnë që nxënësit të kenë sukses në botën e punës dhe të arrijnë rezultate të larta në të ardhmen. Në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar janë përcaktuar tetë kompetencat kyçe që synohen të zhvillohen gjatë gjithë ciklit të arsimit parauniversitar. Këto janë:

- Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare
- Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja
- Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri
- Kompetenca digjitale
- Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit
- Kompetenca qytetare
- Kompetenca e sipërmarrjes
- Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore

Zhvillimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies kërkon që, mësuesi të sigurojë një lidhje të qëndrueshme dhe funksionale midis kompetencave kyçe dhe atyre të lëndës. Kjo arrihet përmes një planifikim të kujdesshëm të situatave të të nxënit, si dhe përzgjedhjen e metodave, mjeteve dhe burimeve të përshtatshme që nxisin angazhimin, reflektimin dhe zbatimin praktik të njohurive.

Kompetenca kuptohet sot si një ndërthurje e balancuar mes njohurive, aftësive, qëndrimeve, vlerave dhe mendimit kritik, që mundësojnë nxënësin të përballët me situata reale dhe komplekse në mënyrë efektive dhe të pavarur. Qasja e mësimdhënies e bazuar në kompetenca e zhvendos fokusin nga përvetësimi pasiv i përmbajtjes lëndore (me mësuesin si qendër të procesit), drejt formimit të aftësive që ndihmojnë nxënësin të kuptojë, të zbatojë dhe të transferojë njohuritë në situata të reja dhe jetësore, duke u vendosur vetë nxënësi në qendër të procesit.

Këto kompetenca zhvillohen jo në izolim, por si pjesë e procesit mësimor në të gjitha lëndët e kurrikulës, përmes angazhimit kognitiv, social, emocional dhe fizik të nxënësve në këtë proces. Mësuesit lehtësojnë zhvillimin e kompetencave kyçe përmes metodave, teknikave dhe qasjeve të ndryshme të mësimdhënies dhe vlerësimit, në një mjedis të sigurt, gjithëpërfshirës dhe të drejtë për të gjithë nxënësit.

Për të lehtësuar punën e mësuesit në zhvillimin dhe vlerësimin e këtyre kompetencave, ato janë zbërthyer në rezultate të nxëni. Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që mund të përmbushen nga nxënësi në klasën e katërt në lëndën e TIK-ut janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1. Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit.

Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare
<i>Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:</i> - lexon saktë me zë një tekst të palexuar më parë; - shkruan një tekst deri 150-250 fjalë e më shumë, për një temë të caktuar; - dëgjon prezantimin e tjetrit dhe diskuton, duke ndërhyrë të paktën dy herë me pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë; - shpreh emocionet që ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, dokumentari, leximit të një libri, interpretimi muzikor, ekspozite, recitimi apo dramatizimi me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.; - identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo ndonjë ngjarjeje nga jeta, bën dallimin e tyre duke bërë një listë me vetitë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rreth tyre, performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë; - prezanton një temë të caktuar para të tjerëve, në kohëzgjatje deri në 10-15 minuta, duke përdorur TIK-un, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët, pyet gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar me kërkimin e të dhënave të tjera.
Kompetenca e komunikimit në gjuhët e huaja
<i>Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:</i> kupton dhe përdor fjalë dhe shprehje të përditshme, të zakonshme;

- shqipton saktë fjalët dhe shprehjet që janë pjesë e fjalorit dhe përdorimit të përditshëm;
- shprehet me fjali të thjeshta për veten, duke dhënë detaje të shkurtra;
- shpreh me gojë dhe me shkrim fjali të thjeshta që i dëgjon në gjuhë të huaj nga mjetet auditive, audio-vizuale, apo nga mësuesi dhe pastaj i përkthen në gjuhën amtare;
- kupton çfarë dëgjon nëse folësi flet ngadalë dhe i shpreh fjalët qartë;
- përdor shprehje dhe fjali të thjeshta në situata të njohura;
- bën pyetje të thjeshta dhe u përgjigjet pyetjeve të tilla;
- realizon dialogë të shkurtër për veten, familjen, shkollën.

Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri

Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:

- lexon, kupton dhe shpjegon tekstin matematik të përshtatshëm për moshën;
- përcjell informacionin matematik me terma, shënime, simbole dhe kode përkatëse;
- arsyeton në mënyrë induktive, kur trajton situata të thjeshta;
- di se njohuritë dhe aftësitë matematike mund të përdoren në jetën e përditshme;
- analizon të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimet ose gjenden në një problemë dhe përdor strategji për të arritur një rezultat apo për të gjetur zgjidhje që më pas mund të shpjegohet, të verifikohet, të interpretohet;
- formulon probleme të thjeshta që mund të zgjidhen;
- vlerëson rëndësinë e matematikës;
- di se detyrat mund të kenë zgjidhje të ndryshme;
- përdor mjete të TIK-ut gjatë nxënies së matematikës.
- planifikon detyra praktike të thjeshta nën drejtimin e mësuesit, formulon pyetje kërkimore dhe kontrollon hipotezat, duke ndjekur rregulloret e

sigurisë, zgjedh instrumente matëse të përshtatshme; analizon të dhënat, nxjerr përfundime dhe paraqet rezultatet e hulumtimit;

- vëren dhe formulon problemet që lidhen me jetën e përditshme dhe ofron zgjidhje për to, merr vendime të arsyetuara duke menduar në mënyrë kritike;
- njeh rëndësinë e shkencës dhe të teknologjisë dhe rreziqet që lidhen me zhvillimin e tyre;
- kupton domosdoshmërinë e dijes shkencore në jetën e përditshme dhe lidhjen e saj me zgjedhjet e ardhshme të karrierës, njeh profesionet që lidhen me shkencat natyrore dhe me teknologjinë në zonat e tyre;

Kompetenca digjitale

Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:

- përshkruan si funksionon interneti, çfarë janë hardueri dhe softueri kompjuterik, jep shembuj të përdorimit të sigurt të teknologjisë digjitale në shoqërinë e informacionit;
- gjen një tekst, pamje, video, animacion të përshtatshëm në internet dhe i referohet burimit;
- krijon, formaton, ruan, riprodhon, si individualisht dhe në bashkëpunim, lloje të ndryshme të përmbajtjes digjitale (tekst, pamje, prezantim, video, animacion etj.) dhe i shpërndan ato, duke ndjekur praktikatat e mira dhe kërkesat e sigurisë digjitale;
- përshkruan dhe shmang rreziqet që lidhen me përdorimin e mjeteve digjitale;
- përshkruan shembuj të jetës reale të përdorimit të programeve për moshën në mjedise argëtuese dhe/ose me robotë edukativë;
- përdor shërbimet online në përputhje me kërkesat e praktikës së mirë dhe të sigurisë digjitale, i drejtohet një prindi, mësuesi ose çdo institucioni që ofron ndihmë për ndihmë kur shfaqet ose dyshohet për një problem.
- zbaton konceptet bazë të kodimit dhe të menduarit kompjuterik për të ndërtuar sekuenca, cikle dhe kushte të thjeshta në mjedise vizuale programimi, duke zgjidhur situata problemore në mënyrë kreative dhe bashkëpunuese.

Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënësit

Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:

- shpreh mendimin duke kërkuar leje nga grupi, respekton mendimin e shokëve, i dëgjon dhe vendos me ta për mënyrat e kryerjes së veprimtarisë;
- shfrytëzon kohën e lirë në të mirën e shëndetit dhe të mirëqenies së tij;
- bashkëpunon me shokët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në klasë, shkollë apo jashtë saj;
- kujdeset për një mjedis të shëndetshëm gjatë një veprimtarie, duke u kujdesur për ajrosjen, ndriçimin, shfrytëzimin e hapësirës, pastërtinë;
- ndjek udhëzimet që jepen në libër apo në material për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë;
- parashtron pyetje dhe përgjigjet për temën / problemin me një nga format e shprehjes;
- mbikëqyr vetë përparimin kur kryen një detyrë ose veprimtari, gjen gabimet dhe i korrigjon ato;
- grumbullon dhe klasifikon materialet e detyrës për përgatitjen apo për pasurimin e portofolit personal;
- identifikon njohuritë që e ndihmojnë të kryejë një detyrë apo veprimtari të caktuar, kërkon këshilla e informacion për kapërcimin e vështirësive.

Kompetenca qytetare

Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:

- shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe vendos për përfundimin e një veprimtarie;
- propozon vlera shoqërore të rëndësishme që të respektohen në klasë, në shkollë apo në familje me anë të shembujve konkretë;
- manifeston veprime që shprehin mirësjellje në situata të ndryshme dhe tregojnë përdorimin e tyre përmes shembujve konkretë.
- propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve, përbërjen dhe rolin e tyre në veprimtari mësimore, këshilla të klasës/shkollës etj.
- identifikon dy ose më shumë organizime shoqërore dhe përshkruan mënyrat se si njerëz me përvoja të ndryshme organizojnë diçka të përbashkët.
- paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhen manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimit me njerëz të panjohur etj.

- shpreh kuptimin e tij për vlerat demokratike dhe respektin për diversitetin;
- vlerëson pjesëmarrjen aktive, përgjegjësinë vetjake dhe zgjidhjen e konflikteve.

Kompetenca e sipërmarrjes

Për të dëshmuar këtë kompetencën, nxënësi:

- mund të japë ide dhe zgjidhje të reja, p.sh., trajton një detyrë që kërkon krijimtari;
- mund të punojë me të tjerët, të ndajë ide dhe të gjejë qëllime të përbashkëta me ata;
- mund të veprojë i pavarur, të kërkojë mundësi të reja dhe të marrë përgjegjësi për veprimet e tij;
- përgatit një projekt të vogël, duke theksuar veprimtaritë kryesore për një çështje, që e shqetëson në shkollë ose komunitet, dhe përcakton kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për zbatimin e tij;
- identifikon dhe llogarit shpenzimet personale ose familjare përgjatë një jave dhe i paraqet ato në formë tabele/grafiku apo në një formë tjetër;
- përgatit paraqitje në formë tabele, grafike apo formë tjetër përkujdesjen për qeniet e gjalla, të cilat mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij.

Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore

Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:

- merr pjesë në veprimtari kulturore brenda shkollës;
- komenton aspekte të ndryshme të kulturës, përfshirë traditat, vlerat, zakonet dhe shprehjet artistike;
- është i vetëdijshëm për trashëgiminë tonë kulturore dhe e vlerëson/respekton atë;
- njeh artefakte kulturore, si: arti, muzika, letërsia dhe zanatet tradicionale nga kultura të ndryshme;
- respekton kulturat e tjera dhe diversitetin e tyre;
- demonstroi qëndrime pozitive ndaj dallimeve kulturore, duke vlerësuar veçantinë dhe shmangur çdo formë diskriminimi.

4.2 Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e TIK-ut

Integrimi i temave ndërkurrikulare në lëndën e Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit (TIK) në arsimin fillor ndihmon nxënësit të kuptojnë lidhjet mes teknologjisë, jetës së përditshme dhe çështjeve globale. Lënda e TIK-u ofron mjedis të pasur për zhvillimin e kompetencave digjitale, mendimit kritik, bashkëpunimit, zgjidhjes së problemeve, si dhe përdorimin e teknologjisë në mënyrë të përgjegjshme. Përmes kësaj lënde, nxënësit mësojnë jo vetëm të përdorin mjetet teknologjike, por edhe të reflektojnë mbi ndikimin e tyre në shoqëri dhe mjedis, duke kontribuar në mënyrë aktive dhe të vetëdijshme në komunitet.

Temat ndërkurrikulare të përcaktuara në Kurrikulën Bërthamë janë:


- Identiteti kombëtar
- Qytetaria aktive dhe sipërmarrja
- Shëndeti mendor, fizik dhe siguria
- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Teknologjia, shoqëria dhe media

Lënda e TIK-ut kontribuon në trajtimin e këtyre temave si më poshtë:

- *Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave:* Përmes projekteve digjitale, si prezantime multimediale, fletëpalosje apo video të shkurtra, nxënësit mund të eksplorojnë dhe paraqesin elemente të kulturës shqiptare, traditat, simbolet kombëtare dhe figurat historike. Ata mund të përdorin mjetet TIK për të hulumtuar dhe ndarë informacion rreth trevave shqiptare, veshjeve tradicionale apo festivaleve kulturore. Kjo i ndihmon të zhvillojnë ndjenjën e përkatësisë dhe të krenarisë për identitetin kombëtar.
- *Qytetaria aktive dhe sipërmarrja:* TIK-u ofron mundësi për zhvillimin e projekteve që lidhen me ndërmarrjen e nismave shoqërore ose ekonomike. Nxënësit mund të krijojnë postera digjitale për fushata ndërgjegjësuere, broshura për produkte imagjinare ose plane të thjeshta të

një ndërmarrjeje duke përdorur mjete të thjeshta të paraqitjes së të dhënave dhe vizualizimit. Ata mësojnë të punojnë në grup, të planifikojnë burime dhe të mendojnë në mënyrë kreative dhe sipërmarrëse.

- *Shëndeti mendor, fizik dhe siguria:* Lënda e TIK-ut mbështet zhvillimin e një qasjeje të vetëdijshme ndaj përdorimit të teknologjisë, duke nxitur mirëqenien digjitale. Nxënësit mësojnë për sigurinë në internet, mbrojtjen e të dhënave personale, respektin në komunikimin online dhe menaxhimin e kohës së shpenzuar para ekranit. Ata mund të krijojnë materiale digjitale që promovojnë zakone të shëndetshme, të përdorin aplikacione për ndjekjen e aktivitetit fizik, ose të diskutojnë për ndikimin e përdorimit të tepërt të teknologjisë në shëndetin mendor.
- *Zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore:* Nxënësit mund të përdorin TIK-un për të krijuar mesazhe ndërgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, duke përdorur fotografi, infografikë apo animacione të thjeshta. Ata mund të analizojnë të dhëna të thjeshta për ndotjen, riciklimin apo kursimin e energjisë dhe të paraqesin rezultatet përmes grafikëve apo tabelave. Kjo i ndihmon të kuptojnë rolin që mund të kenë në ruajtjen e burimeve natyrore dhe rëndësinë e teknologjisë së gjelbër.
- *Teknologjia, shoqëria dhe media:* Lënda e TIK-ut është thelbësore për zhvillimin e shkathtësive për të kuptuar dhe përpunuar informacionin në epokën digjitale. Nxënësit mësojnë të dallojnë burimet e besueshme të informacionit, të analizojnë ndikimin e medias dhe rrjeteve sociale, si dhe të kuptojnë rreziqet e dezinformimit dhe manipulimit të imazheve dhe të dhënave. Aktivitetet si krahasimi i mesazheve nga media të ndryshme, krijimi i posterave për të drejtat digjitale apo diskutimet mbi etikën digjitale i ndihmojnë të bëhen përdorues të ndërgjegjshëm dhe kritikë të teknologjisë.



Shënim: Veprimtaritë praktike për zhvillimin e temave ndërkurrikulare do të përshkruhen në udhëzuesit kurrikularë përkatës të lëndëve.

4.3 Kompetencat e lëndës së TIK-ut dhe rezultatet e të nxënit

Për të përmbushur qëllimet e saj, lënda e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) zhvillon pesë kompetenca, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij. Ndërtimi dhe zhvillimi i këtyre kompetencave synon përmbushjen e qëllimeve të lëndës, duke përgatitur nxënësin që të përdorë teknologjinë në mënyrë funksionale, të sigurt, krijuese dhe etike.

Kompetencat lëndore të TIK-ut	Përshkrimi i kompetencave	Rezultatet e të nxënit për kompetencat lëndore
Operimi teknologjik dhe informacioni	Kjo kompetencë përfshin aftësinë për të përdorur në mënyrë efektive teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK) për të kërkuar, vlerësuar, analizuar dhe menaxhuar informacionin. Ndërmjet kësaj kompetence synohet zhvillimi i njohurive për përdorimin e pajisjeve kompjuterike, programeve softuerike, aplikacioneve të ndryshme, si dhe aftësinë për të identifikuar dhe përdorur burime harduerike dhe softuerike në mënyrë efikase dhe etike.	Nxënësi: ✓ identifikon dhe përshkruan komponentët kryesorë të një sistemi kompjuterik, duke përfshirë njohjen e rolit të pajisjeve hyrëse, dalëse dhe njësisë qendrore të përpunimit; ✓ demonstroi përmes sjelljes dhe qëndrimit të duhur, njohjen e rregullave që duhen respektuar përgjatë punës në kompjuter dhe në mjedisin fizik të laboratorit të TIK-ut; ✓ aplikon konceptin e ruajtjes dhe organizimit të informacionit në kompjuter, duke përdorur komandat e ndryshme për të krijuar dhe menaxhuar dokumentet dhe skedarët; ✓ njeh komandat kryesore të ndërveprimit me pajisjet kompjuterike për të kryer veprime të thjeshta; ✓ identifikon përfitimet dhe kufizimet e përdorimit të teknologjisë së informacionit në aktivitetet e përditshme,

		duke shqyrtuar ndikimin e saj në komunikim, edukim dhe argëtim.
Krijimi i përmbajtjes digjitale	Kjo kompetencë lidhet me aftësinë për të krijuar, modifikuar, organizuar dhe ndarë përmbajtje digjitale në forma të ndryshme, si tekst, grafikë, video, audio dhe elementë të tjerë multimedialë. Nxënësi mëson të përdorë mjete dhe platforma të përshtatshme për moshën, duke zhvilluar aftësi për përpunimin dhe paraqitjen vizuale të të dhënave të mbledhura nga burime të ndryshme, në mënyrë që të komunikojë informacion në mënyrë të qartë dhe efektive. Gjithashtu, kjo kompetencë përfshin njohjen dhe respektimin e të drejtave të autorit, licencave digjitale dhe përdorimin etik të materialeve, duke promovuar përgjegjshmërinë në përdorimin e burimeve digjitale.	Nxënësi: ✓ modifikon dokumente digjitale duke përdorur mjete të thjeshta për formatimin e tekstit dhe përzgjedh mënyra të ndryshme të paraqitjes së informacionit; ✓ krijon produkte digjitale me anë të një programi kompjuterik për vizatimin digjital dhe realizon modifikime të formave dhe elementeve grafike; ✓ krijon piktograme, prezantime dhe animacione të thjeshta duke paraqitur informacionin në mënyrë vizuale dhe tërheqëse dhe realizon projekte grafike të thjeshta; ✓ shkruan dhe formaton tekste të shkurtra digjitale, si përshkrime, tituj ose histori të shkurtra, duke përdorur një aplikacion të përshtatshëm për moshën; ✓ modifikon përmbajtjen digjitale duke ndryshuar elementë si madhësia e tekstit, vendosja e figurave, ngjyrat ose renditja e informacionit; ✓ identifikon mjete të thjeshta për mbledhjen dhe organizimin e të dhënave, si tabela të thjeshta ose grafikë me informacion të mbledhur nga vëzhgime apo pyetësorë;

		✓ respekton të drejtën e autorit, duke përdorur përmbajtje të krijuar vetë ose duke përmendur burimin kur përdor materiale të tjerëve.
Komunikimi dhe bashkëpunimi	Kjo kompetencë lidhet me përdorimin e mjeteve dhe platformave digjitale për të komunikuar dhe bashkëpunuar me të tjerët në mënyrë efektive dhe të organizuar. Nxënësit zhvillojnë aftësinë për të ndarë informacionin dhe për të punuar së bashku në projekte të përbashkëta, duke marrë pjesë në diskutime dhe aktivitete në mjedise online të përshtatshme për moshën e tyre. Gjithashtu, mësojnë të menaxhojnë komunikimet në mënyrë të respektueshme dhe të ndërtojnë marrëdhënie të shëndetshme dhe efektive brenda komunitetit digjital.	Nxënësi: ✓ njeh parimet kryesore të ndërveprimit në mjedisin digjital duke identifikuar teknologjitë dhe platforma të thjeshta digjitale të përshtatshme për të shkëmbyer të dhëna dhe informacion në praninë e personave të rritur; ✓ përdor motorët e kërkimit për të gjetur informacione të besueshme dhe të dobishme për detyrat dhe veprimtaritë e tyre shkollore; ✓ aplikon parimet e qytetarisë digjitale përgjatë ndërveprimit në mjediset virtuale duke respektuar normat e thjeshta të sjelljes online; ✓ dallon mënyrat e komunikimit të përshtatshëm në mjediset digjitale dhe zhvillon aftësinë për të ndërtuar dhe për të mbajtur marrëdhënie efektive në internet; ✓ zhvillon aftësinë për të ndarë informacionin, për të punuar në projekte të përbashkëta, për të marrë pjesë në diskutime online dhe për të menaxhuar komunikimet në mjedise të ndryshme virtuale.

Zgjidhja e problemeve, kodimi dhe të menduarit kompjuterik	Kjo kompetencë lidhet me aftësinë për të aplikuar mendimin logjik dhe algoritmik për të analizuar dhe zgjidhur probleme nëpërmjet mjeteve digjitale. Kjo përfshin aftësitë për të dizajnuar dhe zhvilluar algoritme, për të koduar, për të analizuar të dhëna, për të modeluar probleme dhe për të gjetur zgjidhje optimale ndërmjet përdorimit të mjeteve digjitale dhe aplikimeve të të menduarit kompjuterik.	Nxënësi: ✓ kupton konceptet themelore të kodimit, si blloqet e kodimit dhe sekuencat e kodit të bazuara në tekst për të dhënë udhëzime dhe për të krijuar programe të thjeshta; ✓ krijon kode të thjeshta dhe parashikon se çfarë do të afishohet pas ekzekutimit të një sekuence udhëzimesh, duke testuar dhe verifikuar këto parashikime; ✓ identifikon gabimet në kodin e tij dhe i korrigjon ato, duke përdorur teknika të thjeshta debugging për të përmirësuar funksionalitetin e programeve të krijuara; ✓ kupton logjikën e funksionimit të cikleve dhe instruksioneve kushtëzuese në kod për të krijuar programe efikase dhe për të zgjidhur probleme të ndryshme; ✓ skematizon bllok-skema të thjeshta që paraqesin hapat e një detyre të përditshme dhe përshkruan lidhjet midis elementeve në një bllok skemë, për të kuptuar logjikën e funksionimit të një programi; ✓ aplikon parimet e të menduarit kompjuterik për të ndarë një detyrë në pjesë më të vogla dhe gjen mënyrën më të mirë për të zgjidhur problemin;
--	---	--

		✓ aplikon kodimin vizual për të krijuar veprime të thjeshta, si lëvizje ose përsëritje, në një mjedis digjital (p.sh. platforma për kodim për fëmijë).
Përdorimi i sigurt dhe i përgjegjshëm i teknologjisë	Kjo kompetencë përfshin aftësinë për të mbrojtur veten dhe informacionin nga rreziqet dhe kërcënimet në mjedisin digjital. Ajo përfshin njohuritë dhe praktikën për sigurinë kibernetike, përdorimin e fjalëkalimeve të sigurta dhe mbrojtjen kundër viruseve dhe “malwareve”. Gjithashtu përfshin menaxhimin e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe aftësinë për të njohur dhe reaguar në mënyrë të sigurt duke respektuar parimet e qytetarisë digjitale.	<i>Nxënësi:</i> ✓ ndërvepron në mjediset online duke respektuar të drejtat, përgjegjësitë dhe sjelljen etike; ✓ ndërton vetëdijen për rrezikun e imitimeve dhe kupton mënyrat për të ruajtur identitetin e tij me qëllim shmangien e situatave të rrezikshme online; ✓ kupton rëndësinë e mbrojtjes së informacionit personal dhe aplikon praktikën e sigurta për krijimin dhe përdorimin e fjalëkalimeve; ✓ identifikon përmbajtjet e pasigurta ose të pakëndshme në internet dhe kërkon ndihmë nga personat e rritur për të menaxhuar dhe zgjidhur këto situata; ✓ menaxhon privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe aftësinë për të njohur dhe për të reaguar në mënyrë të sigurt, duke respektuar parimet e qytetarisë digjitale.

V. PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

5.1 Koha mësimore e sugjeruar për secilën tematikë

Lënda e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në klasën e katërt zhvillohet me 1 orë mësimore në javë, për një total prej 35 orësh në vit.. Programi i lëndës së TIK-ut specifikon kohën (orët e sugjeruara) e secilës tematikë. Kjo ka si qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

	Teknologjia dhe bota e kompjuterit	Përmbajtja digjitale	Përpunimi i të dhënave	Të menduarit kompjuterik dhe kodimi	Siguria e të punuarit në kompjuter	Totali i orëve
Klasa e katërt	6 orë	7 orë	4 orë	15 orë	3 orë	35 orë

Në programin e lëndës së TIK-ut për klasën e katërt janë paraqitur përmbajtjet e tematikave:

- Teknologjia dhe bota e kompjuterit
- Përmbajtja digjitale
- Përpunimi i të dhënave
- Të menduarit kompjuterik dhe kodimi
- Siguria e të punuarit në kompjuter

Këto tematika shërbejnë si bazë për ndërtimin e njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave, duke mbështetur zhvillimin e kompetencave të lëndës sipas kërkesave të kurrikulës. Për secilën klasë janë paraqitur tematikat dhe për çdo tematikë janë përcaktuar njohuritë. Koha për secilën tematikë

lidhet, së pari, me rëndësinë e tematikës dhe, së dyti, me shkallën e vështirësisë për t'u përvetësuar nga nxënësit. Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Mësuesit janë të lirë të ndryshojnë me 10% (më shumë ose më pak) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

Mësuesit dhe autorët e teksteve shkollore janë të lirë t'i organizojnë kapitujt dhe renditjen e tyre, por ajo që është e rëndësishme dhe duhet marrë në konsideratë është se tematikat zgjasin përgjatë gjithë vitit shkollor dhe, si të tilla, kapitujt e teksteve nuk mund të jenë të ndarë, por duhet të kenë ndërlidhje dhe vazhdimësi. Gjithashtu, mësuesit duhet të marrin në konsideratë që situatat janë në qendër të zhvillimit të orës mësimore dhe përmes tyre synohet arritja e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve. Për këtë arsye, do të ishte në ndihmë të mësuesve që tekstet të ishin të pasura me situata praktike të marra nga jeta e përditshme.

5.2 Përmbajtja e programit mësimor për klasën e katërt

Në programin e lëndës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për klasën e katërt janë paraqitur pesë tematika përmbajtësore: **Teknologjia dhe bota e kompjuterit, Përmbajtja digjitale, Përpunimi i të dhënave, Të menduarit kompjuterik dhe kodimi, dhe Siguria e të punuarit në kompjuter.** Këto tematika janë bazë për të ndërtuar njohuri, aftësi, qëndrime dhe vlera. Për secilën tematikë janë paraqitur njohuritë, aftësitë, që duhet të demonstrojë nxënësi, ndërkohë qëndrimet dhe vlerat që ai demonstroi në lëndën e TIK-ut përmbledhen për të gjitha tematikat. Tematikat dhe renditja e tyre nuk nënkuptojnë që përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, të zhvillohet e ndarë dhe sipas këtij rendi. Kombinimi i koncepteve dhe aftësive të TIK-ut në situata të të nxënës, kapituj apo grupe temash dhe njësi mësimore, si dhe renditja e tyre, është e drejtë e përdoruesve të programit (kryesorët janë mësuesit dhe autorët e teksteve). Për “përkthimin” e programit në tekste mësimore, aftësitë dhe orët e tematikave do të jenë të shpërndara në kapituj/njësi mësimore të renditura logjikisht njëri pas tjetrit. Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është *rekomanduese*.

Programi mësimor për klasën e katërt në lëndën Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit synon zhvillimin e njohurive dhe aftësive bazë digjitale tek nxënësit. Ata mësojnë të organizojnë dokumentet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, të kuptojnë funksionimin e rrjeteve kompjuterike dhe të internetit, si dhe të eksplorojnë përmbajtjet multimediale në faqet e internetit. Programi prezanton konceptet themelore të

inteligjencës artificiale dhe rëndësinë e vlerësimit kritik të përdorimit të saj. Nxënësit mësojnë të krijojnë dokumente dhe prezantime digjitale duke përdorur mjete të ndryshme, si përpunues teksti, përpunues imazhi dhe mjete të thjeshta të AI-së. Gjithashtu, ata mësojnë të mbledhin, organizojnë dhe interpretojnë të dhëna duke përdorur grafikë të thjeshtë. Një fokus i veçantë në programin mësimor të TIK-ut për klasën e katërt zë zhvillimi i të menduarit kompjuterik dhe kodimit, duke përfshirë elementë si sekuencat, ciklet dhe kushtet. Programi përfshin gjithashtu edukimin për sigurinë në internet, mbrojtjen e informacionit personal dhe sjelljen e përgjegjshme në mjedisin digjital. Ky kombinim njohurish dhe aftësish përgatit nxënësit për përdorimin e sigurt dhe efektiv të teknologjisë në jetën e përditshme, si dhe për zhvillime të mëtejshme në arsim.

Tematika: Teknologjia dhe bota e kompjuterit

Përshkrimi i tematikës

Në këtë tematikë, nxënësit njihen dhe zgjerojnë njohuritë mbi teknologjinë hardware dhe software, duke përshkruar rolin dhe dallimet ndërmjet tyre. Ata praktikojnë menaxhimin e dokumenteve digjitale, duke krijuar, emërtuar dhe organizuar skedarë e dosje në mënyrë të strukturuar, me qëllim ruajtjen dhe përditësimin e versioneve të dokumenteve. Gjatë kësaj tematike, nxënësit njihen me funksionet kryesore të sistemeve operative dhe përshkruajnë rolin e tyre në menaxhimin e pajisjeve dhe në lehtësimin e komunikimit ndërmjet hardware-it dhe software-it. Ata njohin mënyrën se si kompjuterët dhe telefonat lidhen në rrjete lokale dhe përshkruajnë mënyrat e lidhjes me Internetin, përmes kablllove ose teknologjive pa tela (wireless). Nxënësit njohin shërbimet kryesore që përdoren në Internet, si faqet e internetit, email-i dhe rrjetet sociale, dhe përshkruajnë funksionimin e faqeve në internet dhe navigimin nëpër to përmes lidhjeve (linkeve). Në përfundim, ata njihen me konceptet bazë të inteligjencës artificiale dhe mësimin makinerik, duke kuptuar në mënyrë të thjeshtëzuar rëndësinë e të dhënave për trajnimin dhe funksionimin efektiv të këtyre sistemeve.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

- Teknologjia hardware dhe software
- Komponentët kryesorë të njësisë qendrore

Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

Nxënësi:

▪ Menaxhimi i skedarëve dhe kontrolli i versioneve të dokumenteve digjitale ▪ Funksionet bazë të sistemit të operimit ▪ Pajisjet hyrëse/dalëse dhe të dhënat në sistemet fizike ▪ Përdorimi i tastit “shift” ▪ Interneti, rrjeti kompjuterik dhe faqet e internetit. ▪ Bazat e inteligjencës artificiale dhe të dhënat	▪ identifikon dhe dallon pajisjet harduerike dhe softuerike, duke përshkruar dallimet kryesore midis teknologjisë hardware dhe software; ▪ përshkruan funksionet kryesore të komponentëve të vendosura brenda njësisë qendrore të kompjuterit; ▪ krijon, emërton, zhvendos dhe kopjon dosje dhe nën-dosje për të organizuar informacionin në mënyrë të strukturuar; ▪ përshkruan funksionet kryesore të sistemit operativ dhe rolin e tij në menaxhimin e pajisjeve dhe programeve të kompjuterit; ▪ shkruan saktë të dhënat në tastierë, duke përdorur tastin “Shift” për simbole dhe shkronja të mëdha; ▪ dallon pajisjet hyrëse dhe dalëse në sisteme të thjeshta që kryejnë veprime fizike në përgjigje të sinjaleve hyrëse; ▪ përshkruan se një efekt fizik duhet të konvertohet në të dhëna për t’u përpunuar nga kompjuteri; ▪ shpjegon se kompjuterët dhe rrjetet lokale mund të lidhen në një rrjet global të quajtur internet; ▪ analizon mënyrat se si interneti mundëson shkëmbimin e informacionit ndërmjet miliona përdoruesve në mbarë botën; ▪ dallon se pajisjet dhe rrjetet mund të lidhen me internetin përmes kablllove ose lidhjes pa tela (wireless);
---	--

	▪ identifikon shërbimet kryesore që përdorin internetin si: posta elektronike, rrjetet sociale, etj.; ▪ identifikon elementet kryesore të një faqeje interneti si përmbajtja multimediale dhe lidhjet (hiperlidhjet), duke kuptuar se klikimi në një link të çon në një faqe tjetër; ▪ shpjegon se sistemet e inteligjencë artificiale mësojnë nga shembuj të shumtë dhe ky proces quhet “mësim makinerik” (machine learning); ▪ kupton rëndësinë e përdorimit të një numri të madh shembujsh për të trajnuar në mënyrë të besueshme një sistem të inteligjencës artificiale.
Qëndrimi dhe vlerat Nxënësit: ▪ tregojnë përgjegjësi dhe kujdes në përdorimin e teknologjisë dhe pajisjeve digjitale; ▪ respektojnë rregullat e punës në ambientin e laboratorit të TIK-ut; ▪ ndajnë ide dhe bashkëpunojnë me të tjerët.; ▪ kuptojnë rëndësinë e TIK-ut në aspekte të ndryshme të jetës së përditshme; ▪ tregojnë interes për koncepte dhe njohuri të reja në fushën e teknologjisë; ▪ provojnë alternativa të ndryshme kur hasin vështirësi; ▪ zbatojnë rregullat e mirëmbajtjes së kompjuterit; ▪ janë të vetëdijshëm për rëndësinë e të dhënave ▪ kërkojnë ndihmë për problemet që mund të hasin përgjatë ndërveprimit me pajisjet dhe programet kompjuterike.	

Tematika: Përmbajtja digjitale

Përshkrimi i tematikës

Në këtë tematikë, nxënësit zhvillojnë aftësi praktike në përdorimin e programeve profesionale të përpunimit të tekstit dhe imazheve digjitale, si dhe të mjeteve për krijimin e prezantimeve digjitale. Ata mësojnë të përdorin shiritin e veglave për të formatizuar dhe organizuar tekstin, duke përfshirë theksimin, krijimin e listave dhe përdorimin e funksionit “Gjej dhe Zëvendëso” për redaktim efikas. Gjithashtu nxënësit praktikojnë kopjimin e teksteve midis dokumenteve për menaxhim më të mirë të përmbajtjes. Në aspektin e fotografisë digjitale, nxënësit përdorin softuer të thjeshtë për të prerë, rrotulluar, zmadhuar dhe aplikuar efekte në imazhe, të cilat më pas i fusin në dokumente apo prezantime për të përforcuar komunikimin vizual. Përmes krijimit të prezantimeve digjitale, ata bashkojnë tekst, grafikë, sfond dhe animacione të thjeshta për të zhvilluar produkte tërheqëse dhe profesionale, duke përdorur në mënyrë integrale teknologjitë e informacionit dhe komunikimit për të komunikuar idetë në mënyrë efektive.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

Pjesa e parë: Teksti digjital *(Sugjerim: Microsoft Word)*

- Mjedisi i programit Microsoft Word
- Formatimi dhe editimi i tekstit
- Krijimi i listave (bulleted list)
- Rregullimi i hapësirës midis fjalive
- Layouti dhe dizenjimi i dokumentit digjital në Word
- Funksionaliteti “find” dhe “replace”

Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

Pjesa e parë: Teksti digjital

Nxënësi:

- identifikon elementët kryesorë të mjedisit të punës në programin Microsoft Word;
- shpjegon funksionin e veglave të ndryshme për editimin dhe formatimin e tekstit;
- përdor opsionet e formatimit për të ndryshuar stilin, madhësinë dhe ngjyrën e shkronjave në një dokument;
- krijon dhe organizon lista të thjeshta me pika dhe numra për përmbajtje të strukturuar;

	▪ rregullon hapësirën ndërmjet rreshtave dhe paragrafëve për të përmirësuar paraqitjen e dokumentit; ▪ zbaton funksionalitetin “find” dhe “replace” për të kërkuar dhe zëvendësuar fjalë në tekst; ▪ përdor opsione të thjeshta të layout-it dhe dizajnit për të përgatitur një dokument të formatuar nga ana vizuale dhe përmbajtësore.
Pjesa e dytë: Imazhi/fotografia digjitale ▪ Prerja (<i>cropping</i>) i pjesë të padëshiruara të fotografisë ▪ Rrotullimi dhe orientimi (<i>orientation</i>) i fotografisë ▪ Zmadhimi dhe zvogëlimi (<i>zooming</i>) ▪ Aplikimi i filtrave, ngjyra, ndriçim, kontrast etj.	Pjesa e dytë: Imazhi/fotografia digjitale Nxënësi: ▪ përdor funksionin crop për të prerë pjesë të panevojshme të një fotografie; ▪ ndryshon orientimin e fotografisë (rrotullim në të djathtë, të majtë apo kthim përmbys); ▪ aplikon zoom in/out për të parë ose punuar më mirë me pjesë të caktuara të fotos; ▪ eksperimenton me filtra të ndryshëm për të ndryshuar pamjen e fotografisë; ▪ zgjedh dhe ruan versionin e përpunuar të fotografisë dhe inserton brenda një dokumenti digjital versionin final të imazhit.
Pjesa e tretë: Prezantimi digjital ▪ Njohja me mjedisin e punës në PowerPoint ▪ Krijimi dhe organizimi i slajdeve. ▪ Insertimi i tekstit, imazheve dhe formave të thjeshta	Pjesa e tretë: Prezantimi digjital Nxënësi: ▪ përdor mjedisin bazë të punës në PowerPoint për të krijuar një prezantim;

▪ Parimet bazë të dizajnit të një slajdi ▪ Aplikimi i animacioneve dhe tranzicioneve të thjeshta	▪ krijon dhe organizon slajde në një renditje të logjikshme sipas përmbajtjes; ▪ fut tekst, imazhe dhe forma të thjeshta në slajde për të ilustruar informacionin; ▪ zbaton parimet bazë të dizajnit për të krijuar slajde të qarta dhe të lexueshme; ▪ aplikon animacione dhe tranzicione të thjeshta për ta bërë prezantimin më dinamik.
Qëndrimi dhe vlerat Nxënësit: ▪ tregojnë kujdes dhe përpikmëri gjatë krijimit të dokumenteve dhe prezantimeve digjitale; ▪ respektojnë rregullat bazë të sjelljes digjitale, duke respektuar parimet e autorësisë dhe të drejtave të autorit; ▪ vlerësojnë rëndësinë e paraqitjes së qartë dhe të kuptueshme të informacionit në format digjital; ▪ shprehin kreativitetin dhe origjinalitetin gjatë përpunimit të teksteve, imazheve dhe ndërtimit të prezantimeve; ▪ bashkëpunojnë me të tjerët për të realizuar detyra të përbashkëta në mjedisin digjital; ▪ tregojnë përgjegjësi në përdorimin e mjeteve teknologjike, duke ndjekur udhëzimet dhe duke ruajtur punën e vet.	

Tematika: Përpunimi i të dhënave

Përshkrimi i tematikës

Kjo tematikë synon të prezantojë nxënësit me konceptet bazë të përpunimit të të dhënave nëpërmjet përdorimit të tabelave dhe grafikëve të thjeshtë. Nxënësit mësojnë të dallojnë lloje të ndryshme të dhënash si fjalë, numra, data, si dhe të kuptojnë rëndësinë e organizimit të të dhënave përmes mjeteve digjitale si spreadsheet-et. Nëpërmjet ushtrimeve praktike, nxënësit zhvillojnë aftësinë për të futur të dhëna në qeliza të tabelave (duke përdorur rreshta dhe kolona), për të ndërtuar tabela me fusha të qarta dhe për të paraqitur informacionin në mënyrë vizuale përmes grafikëve linearë dhe grafikëve pie chart. Përdorimi i grafikëve i ndihmon nxënësit të kuptojnë dhe interpretojnë më mirë informacionin, duke i dhënë mundësi të zgjedhin formatin më të përshtatshëm për prezantimin e të dhënave. Kjo tematikë mundëson zhvillimin e mendimit analitik dhe aftësitë për të strukturuar informacionin, duke krijuar baza për njohuri më të avancuara në fushën e analizës së të dhënave në vitet në vijim.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

- Llojet e të dhënave, përfshirë: fjalë, numra, data, etj
- Puna me tabelat (spreadsheets)
- Rreshtat, kolonat dhe qelizat
- Futja e të dhënave
- Ndërtimi dhe interpretimi i grafikëve të thjeshtë

Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

Nxënësi:

- mbledh të dhëna dhe dallon llojin e tyre;
- vlerëson përdorimin e tabelave (spreadsheets) si mjete digjitale për të organizuar dhe analizuar të dhënat;
- identifikon qelizat në një tabelë bazuar në pozicionin e tyre referuar rreshtit dhe kolonës përkatëse;
- krijon tabela të thjeshta dhe analizon të dhëna në formë tabelore;
- përdor mjetet bazë të programit për krijimin dhe organizimin e të dhënave në tabela;

	▪ krijon dhe lexon grafikë të formave të ndryshme duke zgjedhur formatin më të përshtatshëm për të paraqitur të dhënat në mënyrë të kuptueshme.
Qëndrimi dhe vlerat Nxënësit: ▪ tregojnë kujdes dhe përgjegjësi në mbledhjen dhe organizimin e të dhënave; ▪ respektojnë rregullat e përdorimit të mjeteve digjitale për përpunimin e informacionit; ▪ bashkëpunojnë dhe ndajnë me të tjerët rezultatet e punës në formë tabelare dhe grafike; ▪ kuptojnë rëndësinë e organizimit të të dhënave për marrjen e vendimeve dhe zgjidhjen e problemeve; ▪ tregojnë interes dhe kuriozitet për përdorimin e programeve të tabelave dhe grafikëve; ▪ aplikojnë me përpikëri dhe saktësi metodat për futjen dhe organizimin e të dhënave në tabela dhe grafikë.	

Tematika: Të menduarit kompjuterik dhe kodimi

Përshkrimi i tematikës

Në këtë temë, nxënësit mësojnë më shumë për mënyrën se si ndërtohen dhe funksionojnë programet duke përdorur diagramet rrjedhëse (flowcharts) dhe nënprogramet (sub-routines). Ata mësojnë të ndajnë problemin e programimit në pjesë më të vogla dhe t'i paraqesin këto pjesë në forma diagramesh, duke treguar se si bashkëpunojnë ciklet, kushtet dhe nënprogramet për të zgjidhur problemin.

Nxënësit përkthejnë diagramet rrjedhëse në kode me tekst duke përdorur tre elementët kryesorë të programimit: sekuencat, kushtet dhe ciklet përsëritëse. Nxënësit kuptojnë se nënprogramet janë grupe udhëzimesh që përdoren më shumë se një herë, duke bërë programet më të thjeshta, më efikase dhe më të lehta për t'u ndjekur e korrigjuar. Gjithashtu, nxënësit avancojnë njohuritë për përdorimin e variabëlve për të ruajtur dhe ndryshuar vlerat gjatë ekzekutimit të programit, si dhe të ndjekin në mënyrë të kuptueshme ndryshimet që ndodhin me to gjatë punës së

programit.". Në këtë tematikë nxënësit gjithashtu prezantohen me vargjet një-dimensionale (arrays) dhe kuptojnë se si numrat e pozicioneve (indeksimi) ndihmojnë për të identifikuar vlerat e veçanta brenda vargut. Në fund, nxënësit krahasojnë se si funksionon programi me diagramin rrjedhës dhe mësojnë të gjejnë dhe të korrigjojnë gabimet logjike që mund të kenë ndodhur në kodin e tyre.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
▪ Përdorimi i strukturave bazë të programimit (sekuenca, kushtet, ciklet) ▪ Analiza logjike e strukturës së programeve ▪ Përdorimi, identifikimi dhe gjurmimi i variablave në program ▪ Parashikimi i ndryshimeve të vlerës së variablave gjatë ekzekutimit ▪ Operacionet aritmetike të thjeshta mbi variabla ▪ Kuptimi dhe përdorimi i nënprogrameve (sub-rutina) ▪ Përdorimi i diagrameve rrjedhëse për planifikim dhe zgjidhje logjike ▪ Krahasimi i logjikës së parashikuar me sjelljen reale të programit ▪ Identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve logjike në program ▪ Përdorimi i vektorëve një-dimensional në programe ▪ Indeksimi i vektorëve një-dimensional	Nxënësi: ▪ aplikon të menduarin logjik për të identifikuar se cilët hapa të një programi kërkojnë përdorimin e strukturave themelore të programimit (sekuenca, kushtet, ciklet); ▪ analizon programet e thjeshta të krijuara nga të tjerët për të identifikuar se ku dhe pse janë përdorur strukturat themelore të programimit; ▪ identifikon pjesët e një programi ku janë deklaruar variabla; ▪ analizon programet e krijuara nga të tjerët për të identifikuar se ku dhe pse janë përdorur variablat; ▪ përdor veprime të thjeshta aritmetike për të ndryshuar vlerën e një variabli; ▪ gjurmon një variabël dhe parashikon si do të ndryshojë vlera e saj gjatë ekzekutimit të programit; ▪ përdor termin “nënprogram” për të përshkruar një grup udhëzimesh të krijuara për të kryer një detyrë të caktuar brenda një programi më të madh, që mund të ripërdoret disa herë; ▪ përdor nënprograme të thjeshta për një qasje më të strukturuar dhe efikase në programim;

	▪ përdor bllokskema për të zhvilluar idetë e tyre në programim, duke paraqitur logjikën dhe rrjedhën e përgjithshme të programit, marrëdhëniet midis nënprogrameve, cikleve dhe kushteve; ▪ krahason funksionimin e programit të tij me parashikimet e bëra përmes bllokskemës, identifikon gabimet logjike në program dhe i korrigjon ato; ▪ përdor vektorë një-dimensionalë në programet e krijuara; ▪ kupton se një vektor një-dimensional është një grup elementësh të dhënash të radhitur një pas një, ku secili element ka një pozicion të caktuar të quajtur indeks; ▪ përdor indeksimet në program për të ndryshuar përmbajtjen e vektorit.
Qëndrimi dhe vlerat Nxënësit: ▪ tregojnë kuriozitet dhe këmbëngulje për zgjidhjen e problemeve përmes të menduarit kompjuterik dhe logjik; ▪ vlerësojnë punën e të tjerëve dhe bashkëpunojnë me respekt; ▪ ushtrojnë mendim kritik dhe krijojnë zgjidhje kreative; ▪ tregojnë kujdes dhe saktësi në ndërtimin e programeve; ▪ vlerësojnë vetëkorrigjimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm; ▪ zbatojnë udhëzime dhe struktura të kuptueshme për të tjerët; ▪ përdorin teknologjinë në mënyrë të përgjegjshme dhe efikase.	

Tematika: Siguria e të punuarit në kompjuter

Përshkrimi i tematikës

Në këtë tematikë, nxënësit zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë për sigurinë në botën digjitale dhe përgjegjësinë që kanë gjatë përdorimit të teknologjisë. Ata mësojnë të identifikojnë kërcënimet dhe rreziqet që ekzistojnë në internet, si mashtrimet, phishing-u dhe keqinformimin, dhe kuptojnë pse është e rëndësishme të jenë të kujdesshëm ndaj përmbajtjeve që marrin dhe ndajnë. Nxënësit zhvillojnë aftësi për të analizuar dhe vlerësuar besueshmërinë e informacionit në internet, si dhe për të kuptuar pasojat personale dhe financiare të besimit të ndaj informacioneve të rreme. Po ashtu, nxënësit mësojnë të krijojnë dhe përdorin fjalëkalime të forta dhe të ndryshme për të mbrojtur informacionet e tyre personale. Nxënësit gjithashtu mësojnë rëndësinë e menaxhimit të kohës që kalojnë para ekranit dhe komunikimit të përshtatshëm në lojëra dhe platforma online, duke zhvilluar përgjegjësi dhe sjellje etike në mjediset virtuale.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
▪ Rreziqet e internetit: mashtrimet, phishing, keqinformimi ▪ Analiza dhe vlerësimi i besueshmërisë së informacionit online ▪ Pasojat e besimit të informacionit të rremë ▪ Menaxhimi i kohës para ekranit dhe video lojërat ▪ Sjellja etike dhe komunikimi i përshtatshëm në mjedise virtuale	<i>Nxënësi:</i> ▪ vlerëson rëndësinë e veprimit etik në mjediset online, duke respektuar privatësinë, pronësinë dhe të drejtat e të tjerëve; ▪ identifikon rreziqet e internetit, si phishing, mashtrimet online dhe keqinformimin; ▪ analizon dhe vlerëson besueshmërinë e informacionit që gjen në internet; ▪ identifikon arsyet pas informacionit të rremë dhe kupton pasojat personale dhe financiare që sjell besimi i informacionit të rremë; ▪ menaxhon në mënyrë efektive kohën që kalon para ekranit dhe përdor sjellje etike gjatë komunikimit në lojëra dhe platforma online;

	vlerëson rëndësinë e krijimit të fjalëkalimeve të forta dhe fjalëkalimeve të ndryshme për mbrojtjen e të dhënave personale.
Qëndrimi dhe vlerat Nxënësit: - respektojnë rëndësinë e privatësisë, pronësisë dhe të drejtave të të tjerëve në mjediset online; - mbajnë qëndrim kritik dhe përgjegjës ndaj informacionit që gjejnë në internet; - kuptojnë përgjegjësinë e menaxhimit të kohës para ekranit dhe përdorin komunikim të përshtatshëm në platforma online; - vlerësojnë nevojën për sjellje etike dhe respekt në ndërveprimet virtuale; - reflektojnë për rëndësinë e krijimit dhe përdorimit të fjalëkalimeve të sigurta.	

5.3 Shembuj veprimtarish për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve).

Në këtë rubrikë paraqiten shembuj orientues të veprimtarive mësimore, të cilat ndihmojnë në realizimin e një rezultati të të nxënit. Këto shembuj janë hartuar për të ilustruar se si aftësitë dhe njohuritë mund të zhvillohen në praktikë gjatë procesit mësimor. Ata shërbejnë si udhëzues për mësuesin, duke ofruar ide konkrete për mënyrën se si mund të angazhohen nxënësit dhe të nxitet të menduarit kritik.

Rezultati i të nxënit	Veprimtaritë
<i>Nxënësi zbaton parimet bazë të dizajnit për të krijuar slajde të qarta dhe të lexueshme.</i>	Aktivizimi i përvojës së nxënësve Mësuesi shfaq dy slajde të ndryshme: një me shumë tekst, ngjyra të forta dhe font të vogël; tjetri me titull të qartë, pak tekst dhe dizajn të pastër. Pyetje për diskutim: “Cili slajd ishte më i lehtë për t’u lexuar?” “Çfarë e bën një slajd të duket i qartë dhe profesional?”

	<i>Zbulimi i parimeve bazë të dizajnit</i> Mësuesi prezanton katër parime bazë: 1. Kontrasti (ngjyra që dallohen mirë me sfondin), 2. Lexueshmëria (fonti i madh, i qartë), 3. Thjeshtësia (teksti i shkurtër, jo i mbingarkuar), 4. Rregulli vizual (vendosja harmonike e elementëve). Tregohet një slajd dhe nxënësit identifikojnë cilat parime janë zbatuar. <i>Ushtrimi në çift</i> Nxënësit analizojnë një slajd të dhënë dhe shkruajnë: “Çfarë do të përmirësoja?” “Cilat parime janë shkelur?” Çiftet bëjnë një listë me 3 rregulla të dizajnit që do t'i zbatojnë në punën e tyre. <i>Krijimi i slajdeve</i> Nxënësit krijojnë 2–3 slajde për një temë të thjeshtë (p.sh. “Hobet e mia” ose “Lënda ime e preferuar”). Mësuesi u kujton të përdorin: ✓ një titull të qartë; ✓ maksimumi 5 rreshta tekst për slajd; ✓ vetëm një ose dy ngjyra për tekstin; ✓ një figurë që lidhet me përmbajtjen. <i>Prezantimi dhe reflektimi</i> • Nxënësit prezantojnë një slajd të përzgjedhur para klasës. • Nxënësit japin vlerësime dhe komente mbi punën e shokëve.
--	---

Shënim: Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e TIK-ut do të përshkruhen veprimtari praktike për përmbushjen e rezultateve të nxënësve.

VI. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Në klasën e katërt, lënda e TIK-ut i ofron nxënësve mundësi për të zhvilluar krijimtarinë dhe aftësitë e tyre për zgjidhjen e problemeve, duke thelluar më tej kuptimin e tyre për disa nga konceptet kyçe që qëndrojnë në themel të teknologjisë digjitale. Synimi është që nxënësit të fitojnë njohuritë, aftësitë, vlerat dhe qëndrimet për t'u bërë krijues aktivë të zgjidhjeve teknologjike dhe jo vetëm përdorues pasivë të teknologjive të krijuara nga të tjerët. Kjo gjë arrihet ndërmjet një kombinimi të balancuar të njohurive teorike të fituara përgjatë procesit mësimor, detyrave praktike që nxisin të menduarin kompjuterik dhe aktiviteteve ku nxënësit zbërthejnë problemet komplekse në pjesë më të vogla të menaxhueshme.

Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënësve është kusht në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Mësimdhënia e TIK-ut udhëhiqet nga parimi se çdo nxënës është i aftë të përvetësojë kompetencën digjitale; ajo synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet, duke u bazuar në mësimdhënien dhe nxënien që ndërton kompetenca, mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien e nxënien e integruar. Nxënësit e një klase janë të ndryshëm për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Përpos kësaj, lënda e TIK-ut kërkon që nxënësit të zotërojnë kompetenca, të përvetësojnë koncepte, të zotërojnë aftësi ndërvepruese. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të përshtatura me nevojat e nxënësve.

Një nga metodat më të sakta të përvetësimit të njohurive në TIK është realizimi i detyrave praktike, në mënyrë që nxënësit të vënë në praktikë njohuritë e marra, si edhe t'i lidhin këto njohuri me njohuritë e lëndëve të tjera. Në arsimin fillor, nxënësit nuk duhet të mbingarkohen gjatë orës së TIK-ut, por përkundrazi të mësojnë nëpërmjet lojës dhe praktikës. Ora e mësimi duhet të bazohet në situata të përshtatura për moshën e nxënësit. Kompjuteri përdoret si mjet për të luajtur me programet, qoftë lojëra zbavitëse mësimore, qoftë programe për shkrim, përpunim të dhënash, prezantime, kërkim në internet ose komunikim. Në këtë mënyrë nxitet kreativiteti, zhvillohet motorika dhe nxitet të menduarit për zgjidhjen e problemeve. Suksesi i orëve mësimore pasqyrohet sidomos në lirinë e fituar të nxënësit për t'i përdorur mjetet e TIK-ut. Nëpërmjet punës në grup,

nxënësi vlerëson bashkëpunimin me shokët e shoqet e klasës, krijon lirshmërinë e vendimmarrjes dhe të përgjegjësisë ndaj komunitetit. Njohuritë e përftuara gjatë orës mësimore bëhen më konkrete dhe më të realizueshme, nëse detyrat lidhen me veprimtaritë në shkollë dhe jashtë saj. Kështu zhvillohet përgjegjësia ndaj komunitetit dhe e komunikimit me të tjerët, duke fituar siguri personale, aftësi në përdorimin e saktë të mjeteve të TIK-ut me një synim të caktuar.

Për nxënësit e arsimit fillor janë të përshtatshme metodat gjysmëkërkimore për zgjidhjen e problemeve. Këto metoda i nxisin nxënësit të kërkojnë vetë në fillim zgjidhjen e problemit dhe më pas të punojnë në grup për zgjidhjen e plotë të tij. Gjatë këtyre hapave, mësuesi ka rolin e lehtësuesit dhe ndihmon nxënësit të arrijnë drejt zgjidhjes së duhur.

Përdorimi i një platforme programimi me udhëzime të integruara dhe detyra të thjeshta siguron udhëzimin e drejtpërdrejtë që u nevojitet nxënësve. Përvoja e të parit të rezultatit të kodimit të tyre, si p.sh., shfaqja e një animacioni, i motivon nxënësit për të kaluar drejt aktivitetit të radhës. Megjithatë, platforma nuk garanton që procesi i të nxënësit është realizuar, duke qenë se nxënësit mund të duan të kalojnë me shpejtësi tek aktiviteti i radhës, përpara se koncepti dhe logjika të jetë ngulitur në mënyrë të qëndrueshme në të kuptuarin e tyre.

Strategjitë e mësimdhënies që nxisin metakognitivitetin, kur nxënësit reflektojnë dhe mendojnë për mënyrën e kryerjes së një detyre, do të ndihmojnë në ngulitjen e koncepteve. Këto strategji përfshijnë programimin në çift, ku nxënësit ndajnë idetë dhe parashikimet e tyre me njëri-tjetrin ose para klasës. Pyetjet, si: *“Çfarë mendoni se do të ndodhë?”*, *“Pse do të ndodhë?”*, *“A ndodhi?”* dhe *“Nëse nuk ndodhi, pse?”* do ta ndihmojnë këtë proces. Nxitja e nxënësve për të biseduar me prindërit mbi atë që kanë mësuar, dhe jo thjesht çfarë kanë bërë, ndihmon në thellimin e kuptimit dhe forcon përfshirjen e prindërve në procesin e të nxënësit të fëmijës. Mësuesit duhet të përdorin edhe format e pyetje-përgjigjes para se të fillojnë shpjegimin e temës së re. Krijimi i diskutimeve në klasë ndihmon në krijimin e një atmosfere të hapur dhe mbështetëse për nxënësit në këtë nivel arsimor.

Tabela e bardhë (whiteboard) nuk duhet të përdoret vetëm si një mjet demonstrimi nga mësuesi gjatë shpjegimit, por edhe si një mjet për përfshirjen e nxënësve në diskutime. Për shembull, në vend që të përdoret thjesht për prezantimin e materialeve mësimore, ajo mund të shërbejë për ndarjen dhe diskutimin e punës së nxënësve me gjithë klasën.

Mësimdhënia e TIK-ut për nxënësit në arsimin fillor përfshin:

Të nxënit aktiv dhe eksplorues: Nxënësit përfshihen në mënyrë aktive në procesin e të nxënit përmes përdorimit praktik të teknologjisë, zgjidhjes së detyrave digjitale, projekteve krijuese dhe përdorimit të aplikacioneve të ndryshme. Ata mësojnë duke eksploruar dhe duke ndërtuar njohuritë e tyre për botën digjitale.

Të kuptuarit e thelluar të koncepteve digjitale: Mësimi i TIK-ut synon që nxënësit të kuptojnë jo vetëm përdorimin e mjeteve teknologjike, por edhe funksionimin, rëndësinë dhe lidhjet midis koncepteve themelore si të dhënat, kodimi, siguria digjitale etj

Të nxënit e bazuar në probleme dhe situata reale: Nxënësit angazhohen në detyra që lidhen me jetën reale, si për shembull: krijimi i një posteri digjital, organizimi i skedarëve personalë, përdorimi i grafikëve për të përfaqësuar të dhëna ose hartimi i një fletë-informimi për sigurinë në internet.

Integrimi i teknologjisë dhe qasjes ndërdisiplinore (STEM): TIK-u është pjesë e natyrshme e qasjes STEM. Nxënësit përdorin mjete teknologjike për të krijuar, modeluar dhe zgjidhur probleme duke stimuluar kreativitetin dhe zbatimin praktik të njohurive në shkencë, matematikë dhe teknologji.

Mësim i diferencuar dhe i përshtatur: Çdo nxënës ka ritme dhe mënyra të ndryshme të të nxënit. Mësuesi përdor strategji të ndryshme, si ushtrime të diferencuara, projekte individuale dhe punë në grup, për të respektuar diversitetin dhe për të nxitur rritjen e potencialit të secilit.

Të mësuarit bashkëpunues: Nxënësit punojnë në grupe për të zgjidhur detyra dhe probleme që kërkojnë mendim kolektiv, krahasim idesh dhe ndarje të përgjegjësisë, duke zhvilluar aftësi sociale dhe profesionale.

Argumentimi dhe komunikimi digjital: Nxënësit mësojnë të shprehin mendimet e tyre, të përdorin gjuhën e saktë teknologjike dhe të paraqesin punimet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke zhvilluar vetëbesim në komunikim.

Përdorimi i stileve të të nxënit dhe vetëvlerësimi. Nxënësit udhëzohen të njohin stilin e tyre të të nxënit dhe të përdorin metoda që i ndihmojnë të përvetësojnë konceptet në mënyrë të qëndrueshme, duke reflektuar vazhdimisht mbi progresin dhe gabimet.

Të nxënit bazuar në projekt dhe lidhja e TIK-ut me jetën reale. TIK lidhet ngushtë me situata të përditshme dhe profesionale që mund të përdoren në projekte të ndryshme, si: prezantime për mbrojtjen e mjedisit, posterë kundër bullizmit online ose analiza e të dhënave për aktivitete shoqërore.

Zhvillimi i qëndrimit pozitiv dhe i vetëbesimit në TIK: Përmes një mjedisi mbështetës dhe sfidues, nxënësit inkurajohen të shohin TIK-un jo si një detyrë të vështirë, por si një mjet që i ndihmon të kuptojnë botën dhe të zgjidhin problemet e jetës.

Zhvillimi i aftësive socioemocionale nëpërmjet TIK-ut: Nëpërmjet punës së përbashkët, të menduarit kritik dhe reflektimit, vetëvlerësimin, nxënësit forcojnë besimin në vetvete, zhvillojnë durimin, kontrollin e emocioneve, këmbënguljen, bashkëpunimin dhe respektin për idetë dhe mendimet e të tjerëve.

6.1 Roli i situatave të të nxënës praktikë nga jeta reale në mësimin e TIK-ut

Përdorimi i situatave praktikë nga jeta reale në mësimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) luan një rol të rëndësishëm në ndërlidhjen e dijes me përvojat dhe nevojat e përditshme të nxënësve. Kjo qasje ndihmon në kuptimin më të thellë dhe të qëndrueshëm të koncepteve teknologjike, duke i bërë ato më domethënëse dhe të aplikueshme.

- *Lidhja me përvojën e përditshme të nxënësit:* Kur të nxënës mbështetet në situata reale, si përdorimi i e-mailit për komunikim, krijimi i një fletëpalosjeje digjitale për një aktivitet shkolle ose përgatitja e një prezantimi, nxënësit kuptojnë se TIK-u nuk është vetëm një lëndë, por një mjet për të vepruar, komunikuar dhe krijuar në jetën e përditshme.
- *Zhvillimi i aftësive të ndërveprimit digjital:* Përmes situatave të të nxënës, nxënësit mësojnë të:
 - menaxhojnë të dhëna personale dhe të respektojnë privatësinë;
 - bashkëpunojnë në mënyrë efektive përmes platformave online;
 - aplikojnë njohuritë në krijimin e përmbajtjeve të tyre (tekste, prezantime, video etj.);
 - vlerësojnë dhe përzgjedhin burime të besueshme informacioni.
- *Aktivizimi i të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemeve:* Situatat nga jeta reale shpesh përfshijnë sfida dhe probleme që kërkojnë zgjidhje, si: “Si të mbrojt një llogari online?”, “Si të paraqes të dhënat e një sondazhi me grafikë?”, “Si të komunikoj në mënyrë të përshtatshme në një grup digjital?”. Këto pyetje nxisin të menduarit kritik, kërkimin aktiv dhe vetëmenaxhimin në të nxënës.

- *Mbështetje për mësim të personalizuar dhe të diferencuar:* Situatat praktike mund të personalizohen sipas interesave të nxënësve (p.sh. krijojnë një poster për një kauzë që u intereson) dhe të përdoren për të mbështetur të nxënësit e diferencuar, duke u dhënë të gjithë nxënësve mundësinë të angazhohen sipas nivelit të tyre.
- *Rritja e motivimit dhe pjesëmarrjes aktive:* Nxënësit janë më të motivuar kur ndjejnë se ajo që po mësojnë ka kuptim dhe përdorim praktik. Kjo qasje i bën më të pranishëm në orë, më të interesuar për të eksploruar dhe më të përgjegjshëm në përdorimin e teknologjisë.

6.2 Roli i projekteve kurrikulare në lëndën e TIK-ut

Projektet kurrikulare janë një pjesë shumë e rëndësishme e mësimin në lëndën e TIK-ut. Ato ndihmojnë nxënësit të mësojnë në mënyrë aktive dhe praktike, duke lidhur njohuritë me përvojat e tyre të përditshme. Nëpërmjet projekteve, nxënësit angazhohen më shumë, punojnë së bashku dhe mësojnë të zgjidhin probleme reale. Në realizimin e projekteve, nxënësit zhvillojnë aftësi të rëndësishme si të menduarit kritik, kreativiteti dhe zgjidhja e problemeve. Ata mësojnë të planifikojnë punën, të provojnë zgjidhje të ndryshme, të bëjnë gabime dhe të përmirësojnë idetë e tyre. Kjo i ndihmon të krijojnë një qëndrim pozitiv ndaj të mësuarit dhe teknologjisë.

Përmes projekteve, nxënësit mësojnë të planifikojnë, të bashkëpunojnë me shokët e tyre, të gjejnë zgjidhje për problemet dhe të shprehin kreativitetin e tyre. Për shembull, ata mund të krijojnë një prezantim me fotografi dhe tekst, të programojnë një lojë të thjeshtë, ose të përpunojnë të dhëna nga një anketë e klasës.

Shpeshherë, projektet inkurajohen të realizohen në grupe, duke nxitur bashkëpunimin, komunikimin dhe ndarjen e përgjegjësisë mes nxënësve. Kjo i ndihmon ata të mësojnë të punojnë së bashku dhe i përgatitë për situata reale, ku puna në grup është e nevojshme. Gjithashtu, projektet u japin nxënësve mundësinë të shprehin kreativitetin e tyre dhe të eksplorojnë interesat përmes mjeteve digjitale. Ata krijojnë përmbajtje të ndryshme, si tregime interaktive, prezantime apo vizualizime, duke mësuar mënyra të reja për të komunikuar dhe për të kuptuar botën rreth tyre.

Këto përvoja nuk ndihmojnë vetëm në zhvillimin e kompetencat digjitale, por krijojnë edhe bazat e nevojshme për të mësuar gjatë gjithë jetës dhe për t'u përballur me sfidat e një bote gjithnjë e më të digjitalizuar.

6.3 Puna me nxënësit me aftësi të kufizuara në lëndën e TIK-ut

Në mësimin e TIK-ut, është shumë e rëndësishme që të sigurojmë një mjedis gjithëpërfshirës ku të gjithë nxënësit, përfshirë ata me nevoja të veçanta, të kenë mundësi të mësojnë në mënyrë efektive dhe të ndihen të mbështetur. Për këtë arsye, aktivitetet dhe materialet e mësimit përshtaten sipas nevojave individuale të nxënësve. Mësuesi përdor mjete dhe metoda të ndryshme, si: përdorimi i teknologjisë ndihmëse (software me lexues zëri, piktograme, mjetet alternative të komunikimit) dhe mënyra të ndryshme prezantimi (audio, video, vizuale). Qëllimi është që çdo nxënës të zhvillojë aftësitë e tij në TIK duke e përjetuar mësimin në mënyrë aktive dhe të përshtatshme. Në lëndën e TIK-ut, kjo nënkupton përdorimin e metodave, teknikave dhe strategjive të përshtatura për zhvillimin e aftësive digjitale, komunikimit dhe ndërveprimit, në një mënyrë të kuptueshme dhe të arritshme për çdo nxënës. Disa prej tyre janë:

- *Përshtatja e materialeve mësimore*, përfshirë materiale me shkronja të mëdha, tekste të thjeshtuara, burime audio dhe vizuale;
- *Zgjedhja e detyrave të diferencuara* që përputhen me nivelin e aftësive të nxënësve dhe stilet e tyre të të nxënës;
- *Krijimi i një mjedisi mbështetës* që inkurajon pjesëmarrjen aktive dhe vetëbesimin e nxënësve;
- *Integrimi i pajisjeve dhe i aplikacioneve digjitale* që ndihmojnë në përmirësimin e aksesit në materiale dhe komunikim;
- *Integrimi i videove, imazheve dhe regjistrimeve* zanore për të përmirësuar kuptimin dhe përfshirjen e nxënësve;
- *Përdorimi i metodave shumë shqisore* që përfshijnë dëgjimin, shikimin dhe prekjen për të lehtësuar të nxënës;
- *Përdorimi i shembujve konkretë dhe të thjeshtë dhe i përvojave praktike* për të mundësuar të kuptuarit e njohurive dhe të aftësive digjitale;
- *Ndihma e bashkëmoshatarëve* nëpërmjet përfshirjes së nxënësve në punë në grupe të vogla për të nxitur bashkëpunimin dhe ndërveprimin.

6.4 Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e TIK-ut

Nxënësit e talentuar në fushën e TIK-ut kanë nevojë për sfida shtesë dhe mundësi për të thelluar njohuritë dhe aftësitë e tyre. Për ta mbështetur këtë, mësuesi organizon aktivitete më komplekse dhe kërkimore, si programim më të avancuar, projekte kreative ose eksplorim të teknologjive të reja. Këto aktivitete nxisin zhvillimin e mendimit kritik dhe kreativ, si dhe rrisin motivimin për të mësuar më tej. Gjithashtu, nxënësit e talentuar

mund të punojnë në mënyrë autonome ose në grupe me bashkëmoshatarë që kanë interes të ngjashëm, duke u përgatitur për sfida dhe mundësi më të mëdha në të ardhmen. Mësuesit duhet të krijojnë mundësi për nxënësit e talentuar që të zgjerojnë dhe thellojnë njohuritë e tyre, të shprehin kreativitetin dhe të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë. Puna me ta është e rëndësishme, pasi:

- Nxënësit e talentuar kanë nevojë për sfida dhe përmbajtje të avancuar që përputhen me aftësitë e tyre për të arritur rezultate të larta;
- Përfshirja e nxënësve të talentuar në veprimtari komplekse dhe sfiduese rrit motivimin dhe angazhimin e tyre në procesin mësimor;
- Këta nxënës shpesh kanë potencialin për të udhëhequr grupe dhe për të ndikuar pozitivisht në mjedisin e klasës;
- Nxënësit e talentuar marrin pjesë në konkurse, olimpiada dhe projekte që përfundojnë me arritje jo vetëm për ta, por edhe për mësuesit dhe shkollën.

Si mund të identifikohen nxënësit e talentuar?

- *Shfaqin lehtësi në përdorimin e pajisjeve teknologjike:* Demonstrimi i një zotësie të natyrshme në përdorimin e kompjuterëve, tabletave apo mjeteve të tjera digjitale që përdoren në mësim.
- *Kuptojnë dhe përvetësojnë shpejt konceptet e reja teknologjike:* Tregojnë aftësi të avancuara për të kuptuar strukturën dhe funksionet e programeve dhe mjeteve softuerike, edhe me pak udhëzime.
- *Tregojnë kreativitet në përdorimin e mjeteve digjitale:* Shfaqin origjinalitet dhe ide novatore në realizimin e projekteve, vizatimeve digjitale, prezantimeve apo punimeve multimediale.
- *Zgjidhin probleme dhe detyra me mendim logjik dhe analitik:* Janë të aftë të analizojnë situata dhe të aplikojnë zgjidhje funksionale në mënyrë të pavarur.
- *Shprehin kuriozitet të vazhdueshëm për teknologjinë:* Bëjnë pyetje që shkojnë përtej përmbajtjes së programit dhe kërkojnë informacion shtesë për teknologjitë dhe zbatimet e tyre.

Në udhëzuesin kurrikularë për lëndën e TIK-ut do të përshkruhen të detajuara veprimtari praktike për zbatimin e metodave të mësimdhënies.

VII. VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të të nxënësve. Ai mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësi. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënësve, si në nivel klase ashtu edhe shkallë të nxënësve. Me këtë informacion, mësuesi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësve, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit të kompetencave të lëndës nga ana e nxënësve. Ndërsa vlerësimi u shërben shumë qëllimeve, është e rëndësishme që mësuesi të përshtatë llojin e vlerësimit me qëllimin specifik të synuar. Para marrjes së një gjykimi në lidhje me një aspekt të caktuar të performancës së nxënësve, mësuesi duhet të sigurojë që mënyra e vlerësimit të përdorur, reflekton saktësisht një aspekt të veçantë të performancës që ka për qëllim të vlerësojë mësuesin. Mësuesit duhet ta përqendrojnë vlerësimin e arritjeve të nxënësve tek kompetencat lëndore si pjesë e natyrshme e mësimin. Në mësimin e TIK-ut, vlerësimi i nxënësve në klasën e katërt është pjesë shumë e rëndësishme e procesit mësimor dhe ndihmon mësuesin të kuptojë se sa mirë po i mësojnë nxënësve njohuritë dhe aftësitë që lidhen me kompetencat e kësaj lënde. Në lëndën e TIK-ut qëllimi i vlerësimit nuk është vetëm vendosja e një note, por synon:

- t'i japë nxënësve mundësi të kuptojë progresin e tij, të mësojë nga gabimet duke reflektuar të përmirësojë njohuritë dhe aftësitë, si dhe të motivohet për të ecur përpara;
- të ndihmojë mësuesin të kuptojë sa mirë nxënësi i kanë kuptuar koncepte dhe po i zbatojnë ato;
- të ndihmojë mësuesin të përmirësojë mënyrën e mësimdhënies.

7.1 Parime të rëndësishme të vlerësimit të nxënësve në lëndën e TIK-ut

Vlerësimi në TIK udhëhiqet nga një sërë parimesh që synojnë të mbështesin të nxënësve, të sigurojnë drejtësi dhe përfshirje, si dhe të përmirësojnë vazhdimisht cilësinë e mësimdhënies. Disa nga këto parime janë:

- ***Vlerësimi mbështet të nxënësve:*** Vlerësimi nuk ka vetëm funksion matës, por shërben si mjet për të përmirësuar të nxënësve e nxënësve dhe për të zhvilluar kompetencën digjitale.

- ***Vlerësimi është i vazhdueshëm dhe i integruar në mësim:*** Vlerësimi realizohet në mënyrë të natyrshme gjatë gjithë procesit mësimor, në çdo aktivitet dhe njohuri të përcaktuar në tematikat e programit mësimor.
- ***Vlerësimi bazohet në kompetencat e lëndës:*** Vlerësimi mat jo vetëm njohuritë e TIK-ut, por edhe aftësinë për të përdorur mjetet dhe pajisjet digjitale në mënyrë të sigurt dhe kuptimplotë, për të zgjidhur probleme, për të krijuar përmbajtje digjitale, për të analizuar dhe menaxhuar informacionin, si dhe për të bashkëpunuar dhe komunikuar në mënyrë efektive në mjedisin digjital.
- ***Vlerësimi është i drejtë dhe gjithëpërfshirës:*** Vlerësimi merr parasysh ritmet dhe nevojat e ndryshme të nxënësve, stilin e të nxënit, nivelin e zotërimit të njohurive dhe aftësive digjitale, duke promovuar barazi dhe përfshirje.
- ***Vlerësimi është i kuptueshëm dhe i shpjgueshëm për nxënësin:*** Nxënësi duhet të dijë qartë çfarë pritet prej tij, si do të vlerësohet dhe për çfarë do të marrë vlerësim.
- ***Vlerësimi nxit reflektimin dhe vetëvlerësimin:*** Nxënësi përfshihet në procesin e vlerësimit, mëson të analizojë punën e vet, të vë në dukje pikat e forta dhe aspektet për përmirësim.
- ***Vlerësimi përdor teknika dhe instrumente të larmishme:*** Vlerësimi realizohet përmes teknikave të ndryshme: vëzhgim, prezantime, punë me shkrim, diskutime, projekte, vetëvlerësim dhe vlerësim nga bashkëmoshatarët.
- ***Vlerësimi udhëzon mësuesin në përmirësimin e mësimdhënies:*** Ai i jep informacion mësuesit për të reflektuar mbi metodat e përdorura, për të identifikuar vështirësitë e nxënësve dhe për të planifikuar ndërhyrje të përshtatura.

7.2 Llojet e vlerësimit në lëndën e TIK-ut

Vlerësimi diagnostikues (vlerësimi si proces të nxëni)

Ky lloj vlerësimi realizohet në fillim të vitit shkollor ose të një kapitulli të ri. Mësuesi zbulon njohuritë që nxënësi ka dhe identifikon çfarë ka nevojë të përsëritet ose të mësohet më mirë. Ky vlerësim ndihmon mësuesin të planifikojë më mirë mësimin, duke përshtatur ritmin dhe mënyrat e punës me nevojat e nxënësve.

Ky vlerësim mund të realizohet:

- ✓ me pyetje të thjeshta dhe të drejtpërdrejta;
- ✓ me ushtrime të shkurtra orientuese;
- ✓ me kuice të shkurtra;
- ✓ biseda reflektuese,
- ✓ fisha vetëvlerësimi.

Vlerësimi formues (vlerësimi i vazhduar, vlerësimi për të nxënë)

Ky vlerësim bëhet gjatë gjithë procesit mësimor, në çdo mësim, për të parë si po ecin nxënësit. Ai ndihmon nxënësit dhe mësuesin të kuptojnë nëse janë në rrugën e duhur dhe çfarë duhet përmirësuar para se të arrijnë vlerësimin përfundimtar.

Teknika të vlerësimit formues janë:

- ✓ vlerësimi i punës në grupe;
- ✓ vëzhgimi i angazhimit dhe pjesëmarrjes;
- ✓ detyra të përditshme dhe projekte të vogla;
- ✓ vlerësimi i diskutimeve dhe argumentimi i zgjidhjeve;
- ✓ vlerësimi i përgjigjeve gjatë mësimit;
- ✓ vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga bashkëmoshatarët, etj..

Vlerësimi formues nga mësuesi bazohet te:

- ***vëzhgimet e mësuesit për nxënësit***, si i realizojnë detyrat praktike në lëndën e tik-ut duke shfaqur aftësi dhe duke mbajtur qëndrime në zgjidhjen e problemeve që mund të hasin;
- ***vetëvlerësimi i nxënësve***, kur ata i kuptojnë pikat e tyre të forta dhe të dobëta duke përdorur kriteret e dhëna nga mësuesi. këto duhet të përqendrohen tek ajo që është mësuar dhe jo vetëm tek ajo që është bërë. në klasë të katërt, një fletë pune “unë mundem...” e thjeshtë mund t'i ndihmojë nxënësit të identifikojnë progresin e tyre dhe t'i motivojë për të ecur më tej;
- ***vlerësimi i nxënësve për njëri-tjetrin***, kur nxënësit i japin komente pozitive njëri-tjetrit lidhur me punën e tyre duke përdorur një seri nxitjesh;

- **evidencat e gjeneruara nga platforma e kodimit**, kur gjurmon progresin e nxënësve nëpërmjet aktiviteteve individuale dhe i siguron mësuesit një raport rreth arritjeve.

Mësuesi duhet t'i përdorë gjithë këto burime evidencash për të bërë vlerësimin formues të nxënësve të klasës së katërt.

Vlerësimi përmbledhës (vlerësimi periodik, vlerësimi i të nxënësve)

Ky vlerësim bëhet pas një periudhe mësimore, ose pas një kapitulli dhe mat atë që nxënësi ka arritur të mësojë. Mund të realizohet me teste, detyra individuale me shkrim, projekte përmblylëse. Kjo zakonisht shoqërohet me notë dhe ndihmon mësuesin, nxënësin dhe prindërit të kuptojnë progresin dhe arritjet.

7.3 Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënësve

Në këtë pjesë jepen *dy shembuj orientues* të niveleve të arritjes për dy rezultate të nxënësit, me qëllim që të ofrohet një ide e përgjithshme për mënyrën e përshkallëzimit të arritjeve të nxënësve. Këta shembuj mund të shërbejnë si pikënisje për mësuesin në ndërtimin e kritereve të vlerësimit të nxënësve.

Shembull 1. Rezultati i të nxënësve (RN): Nxënësi përdor opsionet e formatimit për të ndryshuar stilin, madhësinë dhe ngjyrën e shkronjave në një dokument.			
Niveli i arritjes: Shumë mirë	Niveli i arritjes: Mirë	Niveli i arritjes: Mjaftueshëm	Niveli i arritjes: Dobët
Nxënësi përdor me saktësi dhe vetëbesim të gjitha opsionet e formatimit për të ndryshuar stilin, madhësinë dhe ngjyrën e shkronjave; i aplikon në mënyrë të	Nxënësi përdor saktë shumicën e opsioneve të formatimit për të ndryshuar stilin, madhësinë dhe ngjyrën	Nxënësi arrin të përdorë disa nga opsionet e formatimit për të ndryshuar stilin, madhësinë ose ngjyrën e shkronjave, por me	Nxënësi ka vështirësi të përdorë opsionet e formatimit; nuk arrin të ndryshojë në mënyrë të

qëllimshme dhe krijuese në dokument.	e shkronjave, me ndonjë pasaktësi të vogël.	ndihmën e mësuesit dhe me gabime të pjesshme.	saktë stilin, madhësinë dhe ngjyrën e shkronjave.
Shembull 2. Rezultati i të nxënit: Nxënësi identifikon rreziqet e internetit, si phishing, mashtrimet online dhe keqinformimin.			
Niveli i arritjes: Shumë mirë	Niveli i arritjes: Mirë	Niveli i arritjes: Mjaftueshëm:	Niveli i arritjes: Dobët
Nxënësi analizon dhe dallon saktë format e ndryshme të rreziqeve të internetit (phishing, mashtrime, keqinformim), krahason karakteristikat e tyre dhe propozon mënyra për parandalimin e tyre me shembuj konkretë.	Nxënësi shpjegon dhe klasifikon rreziqet kryesore të internetit, dallon elementët bazë të secilit rrezik	Nxënësi përmend disa rreziqe të internetit dhe tregon njohje të pjesshme të tyre, por ka vështirësi në shpjegimin ose zbatimin e tyre në situata praktike.	Nxënësi shfaq vështirësi në identifikimin e rreziqeve në internetit dhe nuk është në gjendje të shpjegojë natyrën ose pasojat e tyre.

Shënim: Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e TIK-ut do të përshkruhen nivelet e arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit.

VIII. BURIMET DHE MATERIALET MËSIMORE

Burimet dhe materialet mësimore kanë një rol të pazëvendësueshëm në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ato nuk janë vetëm mjete ndihmëse, por themeli mbi të cilin ndërtohet përvoja e nxënësve në klasë. Duke përdorur burime të përshtatshme dhe materiale të ndryshme, mësuesi mund të bëjë mësimin më të qartë, më tërheqës dhe më të kuptueshëm për nxënësit. Kjo ndihmon në aktivizimin e interesit, motivimin dhe zhvillimin e aftësive të tyre.

Burimet mësimore janë të ndryshme dhe përfshijnë libra, fletë pune, materiale vizuale, aplikacione, pajisje teknologjike dhe shumë elementë të tjerë që i përshtaten stilit të të nxënit dhe nevojave të nxënësve. Kur mësuesi i përdor në mënyrë kreative dhe të planifikuar mirë, këto burime i japin mundësi nxënësve të eksplorojnë temat mësimore në mënyra të ndryshme: përmes leximit, dëgjimit, shikimit, praktikës dhe bashkëpunimit.

Mësuesit luajnë një rol kyç në përzgjedhjen dhe përdorimin efektiv të burimeve dhe materialeve mësimore. Në fillim, ata duhet të bëjnë një planifikim të kujdesshëm të mëimit, duke zgjedhur burime që përputhen me qëllimet që duan të arrijnë dhe me nivelin e njohurive të nxënësve të tyre. Një nga aspektet më të rëndësishme është të merren parasysh interesat dhe nevojat specifike të secilit nxënës, që të mund të krijohet një mjedis mësimor sa më i përshtatshëm dhe motivues. Për të bërë mësimin më tërheqës dhe gjithëpërfshirës, mësuesit shpesh përdorin metoda të ndryshme të mësimdhënies duke sjellë materiale të ndryshme si: libra, video, aplikacione, apo lojëra edukative. Kjo ndihmon që secili nxënës të gjejë mënyrën që i përshtatet më shumë për të mësuar, duke e bërë procesin më dinamik dhe më efektiv.

Përveç kësaj, ushtrimet praktike dhe projektet që bazohen në materiale konkrete janë shumë të rëndësishme për të përforcuar njohuritë. Ato ndihmojnë nxënësit të kuptojnë më thellë përmbajtjen dhe t'i mbajnë mend më gjatë konceptet e mësuara, duke u dhënë atyre mundësinë të aplikojnë atë që kanë mësuar në situata reale.

Mësuesit në lëndën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për klasën e katërt mund të përdorin një gamë të gjerë burimesh dhe materialesh mësimore që ndihmojnë në përvetësimin e njohurive dhe aftësive sipas tematikave kryesore të programit. Për të siguruar mësim gjithëpërfshirës dhe motivues, mësuesi mund të përdorë materiale të ndryshme si:

- *Libra mësimore dhe fletë pune* janë baza për nxënësit, ku ata marrin njohuritë kryesore dhe ushtrojnë atë që mësojnë në mënyrë të strukturuar dhe të përshtatur për moshën e tyre.
- *Prezantimet dhe materialet vizuale* e bëjnë mësimin më të qartë dhe më tërheqës, duke ndihmuar nxënësit të kuptojnë më mirë konceptet përmes ilustrimeve, diagrameve dhe videove.
- *Aplikacionet dhe lojërat edukative* angazhojnë nxënësit në mënyrë aktive dhe stimulojnë kreativitetin e tyre, duke u dhënë mundësi të praktikojnë njohuritë në forma interaktive dhe argëtuese.
- *Materialet interaktive dhe platformat online* u japin nxënësve mundësinë të mësojnë vetë dhe në grup, duke përdorur burime që përshtaten me ritmin dhe nivelin e tyre të të mësuarit.
- *Animacionet dhe videot edukative* ndihmojnë në shpjegimin e koncepteve që mund të jenë më abstrakte, si dhe në theksimin e rëndësisë së temave si siguria në internet.

- *Ushtrimet praktike dhe projektet kreative* lejojnë nxënësit të aplikojnë njohuritë në mënyrë aktive, duke zhvilluar aftësi praktike dhe kreativitet përmes punës me detyra konkrete.
- *Platformat dhe mjetet e kodimit për fëmijë* prezantojnë bazat e programimit në mënyrë të thjeshtë dhe tërheqëse. Ato ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë të menduarin kompjuterik, aftësitë për zgjidhjen e problemeve dhe kreativitetin përmes lojërave dhe aktiviteteve interaktive.

8.1 Përdorimi i TIK-ut si mjet dhe teknikë mësimore për zbatimin e qasjes STEM

Qasja STEM është një mënyrë gjithëpërfshirëse e mësimdhënies që lidh Shkencën, Teknologjinë, Inxhinierinë dhe Matematikën për të zhvilluar aftësi të rëndësishme të nxënësit. Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) luan një rol kyç në këtë proces, duke shërbyer si një mjet i fuqishëm për të zbatuar qasjen STEM në mënyrë praktike dhe kreative. Përmes përdorimit të mjeteve digjitale, aplikacioneve edukative dhe platformave të kodimit, nxënësit nxisin të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve, duke u përfshirë në mënyrë aktive në veprimtari që pasurojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre. Përdorimi i TIK-ut i bën mësimet më tërheqëse dhe interaktive, duke i dhënë nxënësve mundësinë të eksplorojnë ide, të krijojnë projekte dhe të bashkëpunojnë në mënyrë inovative. Kjo qasje jo vetëm që i mëson nxënësit konceptet teknike, por i inkurajon ata të jenë kuriozë, të guximshëm në gjenerimin e ideve inovatore. Me TIK-un si mbështetje, nxënësi përgatitet për sfidat e së ardhmes dhe fiton një qëndrim proaktiv ndaj teknologjisë dhe shkencës, duke u bërë pjesë aktive e botës moderne STEM. Qasja STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë) synon të zhvillojë tek nxënësit një mënyrë të integruar dhe praktike të të menduarit, ku lëndët nuk trajtohen veçmas, por lidhen me njëra-tjetrën në kontekst të jetës reale. Në këtë kuadër, TIK zë një vend qendror si mjet dhe si përmbajtje mësimore. Përmes TIK-ut, nxënësit kanë mundësi të përdorin teknologjinë për të eksperimentuar, analizuar të dhëna, ndërtuar projekte dhe zgjidhur probleme me metoda krijuese dhe bashkëkohore.

IX. REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Hartimi i programit të lëndës së Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit (TIK) për klasën e katërt bazohet në Kornizën Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar, Kurrikulën Bërthamë dhe Planin Mësimor të Arsimit Bazë, si dhe në rekomandimet më të fundit evropiane për edukimin digjital dhe zhvillimin e kompetencave të shekullit XXI. Ky dokument u shërben mësuesve, autorëve të teksteve mësimore, hartuesve të instrumenteve të vlerësimit, vlerësuesve të jashtëm, prindërve dhe nxënësve. Më poshtë paraqiten rekomandime për zbatuesit e programit, për të maksimizuar efektivitetin e mësimdhënies në lëndën e TIK-ut.

a) Rekomandime për mësuesit

- Të lidhin përmbajtjen e TIK-ut me fusha të tjera, për të thelluar kuptimin e përdorimit të teknologjisë në jetën reale;
- Të përdorin qasjen STEM dhe aktivitete ndërdisiplinore përmes projekteve, zgjidhjes së problemeve dhe skenarëve praktikë digjitalë;
- Të planifikojnë mësimin në përputhje me moshën, ritmin dhe nevojat individuale të nxënësve, përfshirë nxënësit me nevoja të veçanta ose me aftësi të jashtëzakonshme;
- Të krijojnë një mjedis digjital të sigurt dhe përfshirës, që nxit pjesëmarrjen aktive, bashkëpunimin dhe mirëqenien emocionale të nxënësve;
- Të integrojnë pajisje dhe platforma digjitale interaktive, softuerë edukativë dhe mjete vizuale në procesin mësimor;
- Të përdorin metoda të ndryshme mësimdhënieje (si udhëzimi me shembuj, të mësuarit përmes lojës, të mësuarit përmes projekteve, etj.) për të nxitur të menduarit kompjuterik dhe kreativitetin;
- Të sigurojnë balancë ndërmjet mësimit teorik dhe aktiviteteve praktike duke e përshtatur sipas nevojës dhe kontekstit të klasës;
- Të përdorin udhëzuesit kurrikularë të lëndës dhe materiale ndihmëse për të strukturuar orët sipas objektivave të programit;
- Të dokumentojnë arritjet e nxënësve në përputhje me nivelet e përshkruara të të nxënësit në program.

b) Rekomandime për autorët e teksteve mësimore

- Të sigurojnë që tekstet e TIK-ut të jenë të përditësuara, të përshtatshme për moshën dhe të ndërtohen mbi qasje praktike e gjithëpërfshirëse;
- Të përfshijnë aktivitete dhe ushtrime që nxisin të menduarit kompjuterik, zgjidhjen e problemeve dhe kreativitetin;

- Të lidhin konceptet e TIK-ut me situata reale dhe profesione që lidhen me teknologjinë;
- Të integrojnë shembuj dhe detyra të bazuara në qasje STEM dhe me fokus në përdorimin etik, të sigurt dhe kreativ të teknologjisë;
- Të ofrojnë materiale mbështetëse për mësuesit si udhëzues, plane pune, platforma digjitale dhe materiale multimediale;
- Të sigurojnë qasje të barabartë për të gjithë nxënësit, duke përfshirë diversitetin kulturor, gjuhësor dhe mësimor në strukturën e tekstit.

c) Rekomandime për hartuesit e instrumenteve të vlerësimit

- Të hartojnë instrumente që matin jo vetëm të kuptuarit teorik, por edhe aftësitë praktike dhe digjitale të nxënësve;
- Të përfshijnë detyra me karakter praktik dhe krijues, që matin të menduarin logjik, aftësinë për të përdorur mjete digjitale dhe për të zgjidhur probleme të jetës reale;
- Të respektojnë nivelet e të nxënit sipas programit dhe të përfshijnë ushtrime për të gjitha nivelet e përvetësimit;
- Të sigurojnë që pyetjet të jenë të qarta, të aksesueshme dhe të përshtatshme për të gjithë nxënësit, përfshirë ata me sfond të ndryshëm kulturor e gjuhësor.

d) Rekomandime për vlerësuesit e jashtëm

- Të vlerësojnë mësuesit në bazë të zbatimit të programit dhe përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies në TIK;
- Të vlerësojnë nivelin e përfshirjes së nxënësve në aktivitete praktike, projekte digjitale dhe detyra ndërdisiplinore;
- Të vlerësojnë mënyrën se si mësuesi promovon mësimin e sigurt, etik dhe të përgjegjshëm të teknologjisë;
- Të vlerësojnë përdorimin e mjeteve digjitale për personalizimin e të nxënit dhe për mbështetjen e nxënësve me nevoja të ndryshme;
- Të nxiten mjediset që favorizojnë bashkëpunimin, kreativitetin dhe motivimin e nxënësve.

e) Rekomandime për prindërit

- Të mbështesin fëmijët në përdorimin e teknologjisë në mënyrë të sigurt dhe të ndërgjegjshme edhe jashtë orarit mësimor;

- Të inkurajojnë përdorimin e platformave edukative dhe lojërave që zhvillojnë të menduarin logjik dhe njohuritë teknologjike;
- Të krijojnë një qëndrim pozitiv ndaj teknologjisë si një mjet për të mësuar, komunikuar dhe krijuar;
- Të bashkëpunojnë me shkollën për të ndjekur zhvillimin e fëmijëve në fushën e TIK-ut dhe për të siguruar një mjedis të përshtatshëm për mësim edhe në shtëpi.

f) Rekomandime për nxënësit

- Të marrin pjesë aktive në orët e TIK-ut dhe të angazhohen në zgjidhjen e detyrave praktike dhe projekteve;
- Të zhvillojnë aftësitë për të përdorur teknologjinë në mënyrë krijuese, të sigurt dhe të përgjegjshme;
- Të bashkëpunojnë me shokët në aktivitete digjitale dhe të ndajnë idetë për zgjidhjen e problemeve të thjeshta teknologjike;
- Të eksplorojnë interesat e tyre në fushën e teknologjisë dhe të kuptojnë rolin që ajo luan në jetën e përditshme dhe në të ardhmen profesionale.

X. BIBLIOGRAFIA

1. Australian Curriculum, Assessment and Reporting Authority (2019) *Digital Technologies Years 3–4 achievement standards and elaborations*. Available at: <https://www.australiancurriculum.edu.au/f-10-curriculum/technologies/digital-technologies>
2. Australian Curriculum, Assessment and Reporting Authority (n.d.) *Digital Technologies (Version 8.4)*. Available at: <https://www.australiancurriculum.edu.au/f-10-curriculum/technologies/digital-technologies/>
3. Council of Europe (2025) *European Year of Digital Citizenship Education 2025*. Available at: <https://www.coe.int/en/web/digital-citizenship/eydce2025>
4. Department for Education (2013) *Primary National Curriculum in England: Computing programmes of study*.
5. Digital Technologies Hub (2025) *Scope and sequence Years 3–4*. Available at: <https://www.digitaltechnologieshub.edu.au/teachers/scope-and-sequence/years-3-4>
6. EU-Level Frameworks & Initiatives European Commission, Joint Research Centre (2022) *DigComp 2.2: The Digital Competence Framework for Citizens*. Available at: https://joint-research-centre.ec.europa.eu/digcomp/digcomp2-2-2022-12-02_en
7. European Commission (2021) *Digital Education Action Plan (2021–2027)*. Available at: <https://education.ec.europa.eu/focus-topics/digital-education/action-plan>
8. European Schoolnet (n.d.) *Teaching ICT with Inquiry*. Available at: <https://www.europeanschoolnet.org/academy/course/teaching-ict-inquiry>
9. European Schools' Secretariat (2020) *European Schools' Digital Competence Framework*. Available at: <https://www.eursc.eu/en/European-Schools/Digital-Competence>
10. GOV.UK (2013) *National curriculum in England: computing programmes of study*. Available at: <https://www.gov.uk/government/publications/national-curriculum-in-england-computing-programmes-of-study>
11. Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë (e përditësuar), Ministira e Arsimit dhe Sportit, Tiranë, 2024
12. Kurrikula bërthamë e arsimit fillor, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, 2025.
13. Raspberry Pi Foundation (2025) *The Computing Curriculum*. Available at: <https://www.raspberrypi.org/training/curriculum>
14. School Curriculum and Standards Authority WA (2020) *Year 4 Sample Teaching and Learning Outline: Digital Technologies*. Available at: https://www.scsa.wa.edu.au/__data/assets/pdf_file/0006/Applications/digital-technologies-year-4-outline.pdf
15. Teach Computing (2025) *Key Stage 2 – Year 4 Curriculum Map*. Available at: <https://teachcomputing.org/curriculum/ks2/year-4>